



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.11.2018, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me FIAA (Shoqata e Investitorëve të Huaj), Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Shoqatën e Transportit Qytetas dhe Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë, lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” .

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka, Rrahman Rraja, Gjetan Gjetani dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Patrick Pascal - përfaqësues nga FIAA (Shoqata e Investitorëve të Huaj)

Përparim Alikaj - përfaqësues nga FIAA (Shoqata e Investitorëve të Huaj)

Pandeli Bombaj - përfaqësues nga FIAA (Shoqata e Investitorëve të Huaj)

Xhem Neza - përfaqësues nga FIAA (Shoqata e Investitorëve të Huaj)

Luan Leka- përfaqësues nga Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë

Vullnet Haka- përfaqësues nga Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë

Bujar Bendo – përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë

Hazbi Parllaku – kryetar i Shoqatës së Transportuesve Qytetas

Kujtim Harshova – sekretar i Shoqatës së Transportuesve Qytetas

Nikolin Lera – përfaqësues nga Ministria e Financave

Eduard Shalsi – Të nderuar deputetë,

Në vijim të takimeve intensive që kemi parashikuar përgjatë kësaj jave dhe javës në vijim, në lidhje me diskutimin mbi projektbuxhetin e Shqipërisë, sot pas mbledhjes së parë do të vijojmë me një seancë dëgjimore me grupet e interesit, të cilat i janë drejtuar komisionit parlamentar dhe parlamentit për disa dëgjesa konkrete.

Kemi të ftuar nga Shoqata e Investitorëve të Huaj, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Shoqata e Transportit Qytetas, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, lidhur me shqyrtimin e projektligjit për buxhetin dhe paketën fiskale.

Shoh shumë fytyra të njohura. Ju uroj mirëseardhjen! Kënaqësi që jeni në komision.

Mirë se erdhët!

Do t'u sugjeroja kolegëve që, pa humbur kohë, t'u japim fjalën përfaqësuesve, që të na shprehin edhe një herë shqetësimet e tyre, të cilat i kemi të shkruara edhe në letër. Pastaj do të vijojmë me pyetje-përgjigjet, e më pas me komente, sugjerime.

Dakord me rendin e ditës?

Do të kërkoja t'u caktonim të ftuarve një afat kohor, që të jenë sa më racionalë, në mënyrë që t'u japim mundësinë gjithsecilit të shprehet në lidhje me propozimet apo vërejtje konkrete. Ora është 12 pa një çerek. Kemi një orë e gjysmë në dispozicion, kështu që le ta shfrytëzojnë kohën në mënyrë sa më racionale.

Atëherë, pa humbur kohë, do t'ua jap fjalën përfaqësuesve. Si rregull, flet një person për çdo grup, por në këtë komision nuk është se e kemi zbatuar këtë rregull. Meqenëse nuk është një numër i konsiderueshëm që do të na merrte kohë, mund të flasë gjithsecili nga ju. Vetëm se do t'ju lutesha që të jeni sa më koncizë.

Dakord me rendin, të nderuar kolegë? Në rregull.

Mirë atëherë, e fillojmë me të ftuarit e Shoqatës së Investitorëve të Huaj. Po i marrim sipas renditjes që kemi këtu. Cili do ta marrë fjalën nga ju? Në rregull.

Përparim Alikaj – Unë jam Përparim Alikaj, kryetar i Komitetit të Mineraleve, Naftës dhe Gazit, në Shoqatën e Investitorëve të Huaj të Shqipërisë.

Ka mbi dy javë që ne jemi njohur me draftin e propozuar nga qeveria, e për këtë qëllim, të martën e kaluar bëmë një dëgjese publike në Ministrinë e Infrastrukturës e të Energjisë, me zëvendësministrin Enis Aliko, me drejtorin e Përgjithshëm të Licencave, Mehmet Hasalami, si dhe me dy përfaqësuese nga Ministria e Financave.

Në këtë takim ne shprehëm shqetësimin në lidhje me dy problemet kryesore që kemi ne, zhavorret bituminoze dhe kromin. Në këtë takim ne shprehëm shqetësimin në lidhje me dy problemet kryesore që kemi, zhavorret bituminoze dhe kromin, për rritjet përkatëse të akcizës në zhavorrin bituminoz, për të cilin do të flasin edhe të tjerë, ndaj nuk po zgjatëm në këtë pikë, që t'i lëmë specialistët përkatës ta trajtojnë këtë çështje, si dhe për rritjen me 3 %, pra nga 6 % në 9 % të rentës minerare të kromit.

Shkurtimisht, po paraqes vetëm disa të dhëna për kromin, se ku mbështetemi ne, gjë për të cilën edhe në mbledhjen e asaj dite na dhanë të drejtë, se do të rishikohej kjo punë, meqenëse ishte një ngritje shqetësuese për industrinë e kromit.

Mund t'ju them se në vitin 2017 janë prodhuar rreth 730 mijë ton për gjithë vitin.

Eduard Shalsi – 700 e sa?

Përparim Alikaj – 730 mijë ton krom.

153 mijë ton krom i pasur janë dërguar për shkrirje në uzinat e ferrokromit.

Eduard Shalsi – Përpunim.

Përparim Alikaj – Përpunim për shkrirje, se ka edhe përpunim për pasurim. Pra, për ferrokrom. Të dyja këto janë brenda vendit. 162 mijë ton krom i varfër janë dërguar në fabrikat e pasurimit. Tashti 415 mijë ton i pasur janë dërguar për eksport, kryesisht në Kinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Edhe një herë të lutem!

Përparim Alikaj – 415 mijë.

Eduard Shalsi – Kryesisht në Kinë, thatë?

Përparim Alikaj – Po, në Kinë.

Gjatë vitit 2018, kapaciteti i uzinave të ferrokromit mendohet të rritet në 288 mijë tonë, pasi do të vihen në shfrytëzim disa furra të reja. Pra, nga 153 mijë në 288 mijë. Ne nuk e dimë si është situata konkrete, por mendojmë se në 2019-ën të jetë bërë realitet.

Po të bëjmë një hesap shumë të thjeshtë, na mbeten rreth 300 mijë ton krom, që nuk përpunohen dot në vend, meqenëse nuk ka kapacitete përpunuese. Ligji e ka: ose të shkojnë për shkrirje në uzinën e ferrokromit, po që i pasur, ose do të shkojë në fabrikën e pasurimit, po që i varfër.

Tani na mbeten 300 mijë ton, të cilat nuk marrin rrugë. Duhet të shkojnë drejt eksportit. Disa nga këta do të penalizohet me rritje të rentës minerare nga 6 % deri në 9%. Kjo rritje nuk

është pak, por me rreth 7 dollarë. Me 3- përqindëshin, që e kanë ata të cilët e përpunojnë në vend, diferenca bëhet mjaft e madhe, rreth 14 dollarë.

Kjo duket shifër e vogël, por po të kemi parasysh edhe çmimin e kromit, që ka rreth 6 muaj, një vit që ka rënë, duke vajtur në nivelin 210 – 215 dollarë për ton, nga 300-350 që ka qenë, një ngritje e tillë e rentës minerare do të penalizojë shumë prodhues mesatarë dhe të vegjël, sa t'i detyrojë të ndalojnë prodhimin.

Veç të tjerave, kjo do t'i shkaktonte vendit një humbje ekonomike, por do të kelt po ashtu edhe probleme sociale.

Kemi dëgjuar nga përfaqësuesit e Ministrisë së Financave të thonë: “po mirë, por mbase kromi është në përfundim, edhe dhjetë vjet krom mund të ketë, kështu që le ta pakësojmë kromin.”

Kjo më duket jashtëzakonisht e gabuar. Para viteve '90, Shqipëria ka qenë një vend prodhues i kromit, i treti në botë, në vlera absolute. Kromi është një mineral që i ka shërbyer ekonomisë sonë për shumë vjet, dhe do të vazhdojë t'i shërbejë.

Ne kemi një problem: që ligji minerar për kërkim-zbulimin ka shumë të meta. Ka mbetur që nga viti 2010, kur është aplikuar me të meta. Është hera e tretë që e ngre në komision parlamentar problemin e korrigjimit të ligjit minerar. Nuk po hyjmë në trajtimin e të metave, se s'dua të ndaloj këtu, por ky ligj bën që sot të mos rrotullohet më asnjë sondë shpimi në kërkimin e kromit dhe të bakrit në Shqipëri. Ky është fakt. Nuk ka asnjë kompani të vendit ose të huaj, që të punojë në kërkim-zbulim. Këtu duhet parë e meta, sepse ne duhet t'i shtojmë rezervat e kromit e të bakrit, e jo të ulim rezervat e shfrytëzimit. Kësaj i thonë të ecësh mbrapsht. Ka shumë familje, të cilat e mbështesin jetën e tyre pikërisht në këtë gjë.

Gjithashtu, do të thosha që, në qoftë se ne i vendosim prodhuesit e kromit vetëm që të çojnë mineralin e tyre, sidomos të varfrin, në fabrikën e ferrokromit, kjo do të çojë në një lloj monopolizimi, sepse ata do të diktojnë çmimin. Fabrikat e pasurimit, fabrikat e shkrirjes së ferrokromit diktojnë gjithmonë çmimin. Pra, a duhet t'u lëmë atyre një hapësirë? Ne nuk e kemi këtë mundësi, që të kemi kapacitete prodhuese aq sa ç'është prodhimi i kromit. Nga ana tjetër, i themi: ose shko te ai, ose do të rritet me 9 %. Ai thotë: po shkoj te ai, por nuk ma merr, sepse aq e ka kapacitetin. Atëherë, po e çove në Kinë, do të jetë 9 %. Kjo nuk është e drejtë. Është rritje krejt e padrejtë. Nuk ka asnjë bazë logjike rritja me 9 %. As me 1 % s'ka pse të rritet. Sepse penalizohen vetëm ata që nuk e çojnë dot mineralin në fabrikë ose në uzinën e ferrokromit.

Pra, ky është një defekt mjaft i madh. Në atë dëgjuesën publike që kemi bërë, ku ishin pa përjashtim të gjitha kompanitë përfaqësuese të kromit në Shqipëri, përfshi edhe përfaqësuesit e ministrisë, të gjithë ranë dakord se ky është një problem që duhet zgjidhur.

Unë këto kisha. të tjerët mund të flasin vetë. Zoti Xhem Neza është përfaqësues i një kompanie të kromit, por ai mund të flasë për detaje, të cilat mund të dalin nga pyetjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jep 2 milionë e 100 mijë dollarë. Kaq.

Eduard Shalsi – Po.

Xhem Neza – Faleminderit!

Unë jam Xhem Neza, përfaqësuesi i kompanisë MALI sh. p. k. Kam njëzet e dy vjet që merrem me këtë lloj biznesi. Licenca ime është e treta në Shqipëri. Operoj në zonën e Tropojës, kryesisht në minierën Kam-Tropojë dhe Rragam.

Sa i takon eksperiencës, edhe në periudhën para licencimit, kur kam punuar si privat në minierën e Kam-Tropojës, unë kam 30 vjet që merrem me këtë biznes. Referuar çfarë u tha, që të mos e përsëris kolegun, përveç detajeve që përmendi ai, detaj kyç në përlllogaritjen e rentës është edhe metodika e përlllogaritjes.

Nëse sot i referohemi çmimit të eksportit prej 210 dollarësh, metodika e përlllogaritjes së rentës nuk është për 210 dollarë, po mbështetet në çmimin e referencës, i cili është afërsisht 33 mijë e 800 lekë. Pra, pothuajse është më i madh se sa çmimi i shitjes. Aktualisht, edhe sot që flasim, renta nuk është 6%, por 13%. Në dogana kështu paguhet. Unë e vuaj çdo ditë këtë. U jam drejtuar edhe me shkrim doganave, por s'përgjigjet askush.

Tjetër, që nga viti 2013 kemi hasur edhe një rast shumë specifik. Për ata që janë specialistë, e mesa duket, për fat, njëri nga anëtarët e komisionit, deputeti i nderuar, është edhe inxhinier gjeolog, dihet e lagështia në mineral, kur minerali shitet, zbritet. Ne jemi gjobitur si biznese për shkak të përmbajtjes së lagështisë. Pra, renta llogaritet bashkë me lagështinë, bashkë me transportin, sepse edhe për koston e transportit, nga vendi ku niset minerali, paguhet rentë, deri në Kinë. Edhe për shërbimet portuale, përsëri ky 6-përqindësh është i llogaritur.

Siç tha edhe Përparimi, nëse u referohemi vendeve ku gjenden minierat, përjashtojmë ndonjë rast specifik, zonën e Pogradecit apo më duket edhe zona e Voskopojës, që ka **lumokron**, të gjitha minierat janë në Veri, kështu që kostoja e transportit është shumë e lartë.

Sot unë paguaj afërsisht 22 dollarë për një ton, vetëm për transport, që nga miniera ime e deri në portin e Durrësit. Shtojmë edhe rastet kur jam detyruar – sepse në rastet kur s'ka treg jashtë, kam kontrata edhe brenda – ta marr përsëri nga Durrësi për ta çuar në Elbasan. Në këtë mënyrë, sipas rasteve, shtohet një kosto transporti prej rreth 4, 5 – 5, 5 dollarë, sipas rasteve.

Nisur nga kapaciteti i përpunimit, nëse i referohemi faktit, sepse këtë e them me fakt, sot të gjitha uzinat në Shqipëri kanë kapacitet të kufizuar. Një nga firmat me të cilën unë punoj, GSA-ja, ka kapacitet përpunues prej 2000 ferrokrom në muaj ose 6000 tonë krom bruto.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për mineralin e kromit të gatshëm, që çohet për përpunim, raporti është një me tre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, në përpunim. Për të prodhuar një ton ferrokrom duhen tre tonë krom. Raporti i përpunimit është një me tre. Nëse rritet renta, kapaciteti i përpunimit në Shqipëri është shumë i ulët në raport me sasinë e prodhimit.

Duke iu referuar vitit 2017, në gjithë historinë e prodhimit të mineralit të kromit në Shqipëri, vetëm viti 1989 ka qenë më i miri, me 1 milion tonë. Në raport me gjithë eksperiencën time, vetëm viti 1989 ka qenë 1 milion tonë. Është prodhim shumë i lartë. Pra, gjithmonë mbeten në ajër 300 mijë deri në 400 mijë, kështu që të gjitha këto biznese janë drejt falimentimit. Aktualisht, në Tropojë janë në prodhim vetëm tri miniera, në Kukës janë dy, ndërsa të tjerat pothuajse janë mbyllur. Arsyeja është se nuk ka treg.

Për shembull, ka njëzet vjet që unë kam 50 punëtorë. Tashmë nuk kam rrugë tjetër, veçse të shkurtoj numrin e punëtorëve. Në këtë rast efekti social është shumë i madh. Nuk kam fuqi t'i mbaj. Shteti, në vend që ta stimulojë këtë industri, me këto lloj tarifash të taksave kombëtare po e çon drejt ndalimit përfundimtar. Të gjitha të ardhurat i kemi kthyer në investim për këtë fushë.

Eduard Shalsi – Qartë!

Rrimë te kjo pikë, që ta ezaurojmë, pastaj të kalojmë te tema tjetër Ka pyetje ndonjëri nga kolegët?

Besnik Baraj – Më duket absurde të vendosen tarifa mbi bazën e lagështisë, sepse ajo varion nga koha e të tjera. Kjo duhet bërë mbi bazën e përmbajtjes së Cr2O3-shit.

Xhem Neza – Jam dakord në lidhje me përmbajtjen e Cr2O3-shit, por nuk bëhet kështu. Doganat kanë vënë çmim reference. E thashë edhe një herë: është 210 dollarë çmimi i

referencës, për përlllogaritjen e rentës është 33 mijë e 800. Po marrim si shembull një komponent X: 42 %.

Eduard Shalsi – Pra, është vendosur çmim reference në një kontekst çmimi të caktuar?

Xhem Neza – Me një udhëzim administrativ.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Sa ka qenë çmimi atëherë, kur është vendosur çmimi i referencës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Xhem Neza – Nga 258 deri në 320 ka qenë kur është vënë kjo, dhe s'ka ndryshuar më kurrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kam mbi dy vjet që e paguaj kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Pra, në qoftë se shkon 500... sapo zbret, e kanë mbi kurriz ata.

Ka ndonjë koleg tjetër që do fjalën?

Xhem Neza – Zoti kryetar, më fal, vetëm një rast që është ngritur çmimi e kanë bërë këtë përlllogaritje në funksion të referencës, e më aps s'e ka lëvizur më kurrë.

Eduard Shalsi – Në rregull! Qartë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Bitri!

Mikrofonin, ju lutem!

Robert Bitri – Ku e masni ju sasinë që eksportoni apo çoni për pasurim?

Xhem Neza – Të gjithë e masim në port, pa përjashtim. Të gjithë kemi sheshet tona.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ose edhe në uzinat e ferrokromit, destinacioni fundor.

Robert Bitri – Pra, ajo që shitet apo ajo që çohet atje nuk është bruto, por neto?

Xhem Neza – Edhe në e nis për eksport, sasinë e mat dogana.

Robert Bitri – Po mos e quaj bruto, quaje neto. Sasia është ajo që eksportohet ose ajo që përpunohet, pra, që ta merr ai në përpunim.

Xhem Neza – Po, sigurisht.

Robert Bitri – Pra, me këtë rast, atë firon që përmendët ju, nga bruto në neto, s'kemi pse e quajmë bruto, sepse edhe lagështia edhe ajo tjetra kanë ikur.

Xhem Neza – Jo, të lutem!

Robert Bitri – Sepse the se ta zbret ai, apo jo?

Xhem Neza – Për pagesë, si s'ta zbret. Këto i kam me fakte.

Robert Bitri – Pra, ta zbret për pagesë.

Xhem Neza – Një matematikë e thjeshtë: nëse lagështira e mineralit është 3, 5 %, nëse ti ke 1 mijë tonë, fatura e pagesës të vjen minus 3, 5 % e lagështisë, ndërsa rentën e paguan edhe me lagështirë. E kuptoni? Pra, është diskriminim.

Robert Bitri – S'ka logjikë kjo. Ty duhet të paguhet ajo që shitet. Kush ta mat ty sasinë atje?

Xhem Neza – Unë se kam sot me vete, por mund t'jua sjell edhe xhirimin, për gjobën prej 15 milionë lekësh, që u kam paguar doganave.

Robert Bitri – Kjo s'ka logjikë, sepse kush e mat, derisa s'ta masin në nxjerrje, derisa s'ta masin gjatë transportit, por ta masin vetëm kur ti e shet për eksport ose kur e çon për përpunim. Pra, sapo ta jep fabrika të përpunuar, apo sa të jep ai që e blen, këto duhet të jenë dy faturat.

Xhem Neza – Keni të drejtë ju, që duhet të jetë kështu, por në fakt s'është kështu. Ai ta zbret, ta llogarit rentën edhe me lagështi. Kjo është e paimagjinueshme.

Eduard Shalsi – Po nga i merr të dhënat?

Xhem Neza – E merr nga fletë-analiza, që ti ia bashkëngjit, kur e dorëzon mineralin në doganë. Aty është sasia dhe përmbajtja e lagështisë së mineralit. Në bazë të kësaj, ai të llogarit rentën, duke marrë në konsideratë peshën me lagështi, ndërsa pagesën e merr pa lagështi.

Eduard Shalsi – Qartë, qartë! Në rregull!

Mbaruam me këtë pjesë? Ka ndonjë koleg tjetër? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndize pak mikrofonin, të lutem, dhe afroje!

Pandi Bombaj – Unë jam Pandi Bombaj, inxhinier minierash, me detyrë si menaxher i projekteve në grupin e shoqërive franceze, në të ku janë katër shoqëri, dy prej të cilave janë edhe prodhuese të zhavorrit bituminoz, që është edhe objekt i diskutimit.

Me njohjen e paketës fiskale, ne vlerësuam në mënyrë të veçantë vendosjen e akcizës për zhavorrin bituminoz, arsye për të cilën bëmë një analizë të kësaj takse.

Këto mendime i kemi shprehur që në dy mbledhjet e para, por në dëgjesën publike që u organizua, ku ishte edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, ne bëmë një pyetje, që është normale për çdo mbledhje: Ministria e Financave, që ka qenë iniciatorja e vendosjes së kësaj takse, ka bërë ndonjë analizë ekonomike në lidhje me këtë akcizë? Domethënë, çfarë të ardhurash futen në buxhetin e shtetit dhe çfarë efektesh të tjera ka? Përgjigja ishte që nuk kishin bërë analizë. Në fillim e vunë dy lekë për kilogram, por duke parë reagimin e shoqërive tona e ulën në një lek.

Pra, analizë nuk kanë bërë, ndërkohë që ne e kemi analizuar thellësisht këtë problem. Bazuar në argumentet teknike, ekonomike e sociale, nuk ka asnjë lloj hapësire për të vendosur akcizë mbi zhavorrin bituminoz.

Në analiza teknike, në të cilën ne bazohemi, ne i referohemi ligjit të akcizave, ku janë produktet energjetike, në të cilat bënë pjesë edhe zhavorri bituminoz. Të gjitha produktet që kanë akcizë, lëndët djegëse, siç është koksi, por jo mineralet e ngurta, që janë në gjendje natyrale, të papërpunuara.

Po të shikosh në të gjitha vendet e Bashkimit Europian, në produktet minerare të papërpunuara nuk ka akcizë. Pra, akciza është mbi produktet që rrjedhin nga përpunimi i naftës në uzinat e përpunimit. Tani, të vësh shenjën e barazimit të koksit të naftës, që është alternativë për të zëvendësuar zhavorrin bituminoz, është krejtësisht gabim.

Koksi i naftës është një produkt i pastër, që pothuajse 96 % e tij është masë e djegshme, që digjet, prodhon nxehtësi dhe ka fuqi kalorifike të lartë, prej 8 mijë kilokalori, ndërsa zhavorri bituminoz, që prodhojmë ne, në vendburimin e Selenicës, është një mineral, i cili ka rreth 50% sterile dhe 20% ujë, sepse ato e mbajnë lagështirën.

Pra, ne vëmë shenjën e barazisë të një mineral që ka 30% masë të djegshme me një produkt naftë që ka 96% masë të djegshme. Në sensin teknik kjo nuk ka kuptim, pra që të vihet shenja e barazimit mes këtyre dy produkteve, duke pasur parasysh edhe përvojën, edhe si funksion në vendet e BE-së, ku lëndët djegëse të ngurta nuk kanë akcizë, se nuk ka arsye të vihet akciza.

Argumenti i dytë është argumenti ekonomik, i cili është edhe motivi nga i cili është udhëhequr Ministria e Financave, megjithëse nuk na thanë se kanë bërë analizë, por ne kemi bërë analizën tonë.

Aktualisht, sot zhavorri bituminoz që prodhojmë ne është me një fuqi kalorifike mesatare 4000 kilokalori dhe ka një çmim në treg, konkretisht në Fabrikën e Çimentos “Titan”, 22 euro për ton, pa TVSH.

Atëherë, nëse do t’i vihet akciza, që është 1 lek për kilogram, do të thotë se do t’i rritet çmimi në një vlerë të tillë që nuk është më konkurrues në treg dhe përdoruesit e tij, që janë fabrikat e çimentove, natyrisht do të gjejnë alternativa të tjera ose në vend, ose në import.

Ai është një vendburim shumë i vështirë, ku ka filluar shfrytëzimi 2000 vjet përpara, në mënyrë të organizuar në vitin 1871. Pra, vendburimi ka filluar nga kuota plus 200 dhe ka shkuar sot minus 54 dhe është rrahur gjithë burimi me punime minerare.

Janë bërë rreth 600 mijë metra linearë në të gjithë vendburimet, pra ai vendburim është bërë shoshë, ekuilibri i formacioneve është prishur dhe rezervat kryesore janë shfrytëzuar. Kanë mbetur brenda vetëm humbje teknologjike, të cilat janë humbje që janë nxjerrë jashtë bilancit, se është një vendburim me raport gjeologjik, i pari nga rusët, pastaj nga socialistë shqiptarë dhe janë miratuar rezervat e tij. Këto rezerva që janë humbje teknologjike janë brenda. Çfarë bëjmë ne dhe kompanitë e tjera?

Ne hapim karriera dhe shfrytëzojmë mbetjet teknologjike, pra bëjmë vlerësim të këtyre rezervave. Shteti ka një avantazh këtu, se ato rezerva, që janë quajtur të humbura, ne i vlerësojmë dhe po shfrytëzojmë. Pra, kjo iniciativë që është marrë nga këto kompani është një iniciativë që duhet mbështetur.

Duke qenë se këto janë rezerva të pakta, aty ka një koeficient zbulimi shumë të lartë, për të nxjerr 1 ton zhavorr bituminoz duhet të heqësh 15 metër kub sterile, të cilat duhen gërmuar, ngarkuar, transportuar dhe duhen sistemuar, se është ligji për mbrojtjen e ambientit që duhet ta zbatojmë.

Kështu që kostoja është e lartë dhe fitimi është i vogël, mesatarisht 500 lekë për ton. Nëse ne vëmë akcizën 1000 lekë/ton, se është 1 lek/kg, atëherë këtu nuk ka asnjë hapësirë në aspektin ekonomik për t’i vënë akcizë.

Problemi është ky, se analiza nuk është bërë nga Ministria e Financës, nëse vëmë këtë akcizë, çfarë hyn në buxhetin e shtetit dhe çfarë mungon në buxhetin e shtetit? Nëse do të ndërpritet veprimtaria prodhuese e zhavorrit bituminoz, lënda bazë që përdoret janë kryesisht karburantet, atëherë rreth 700 mijë litra karburante, që dalin sipas normativave të harxhimit që kemi aktualisht, do të mungojnë në treg. Nëse do të mungojnë këto, do të mungojnë në buxhet

taksat që janë mbi karburantet, që është akciza 37 lekë/litër, taksa e karbonit, taksa e qarkullimit, taksa e markimit e me radhë. Të gjitha këto shkojnë 70 lekë/litër dhe në qoftë se e bëjnë llogarinë 70 lekë/litër me 700 mijë, i bie që do të mungojnë në buxhetin shtetit nga mospërdorimi i karburanteve në Selenicë, 49 milionë lekë.

Gjithashtu, nëse nuk do të punohet, do të mungojë renta minerare, vlera e së cilës është 186 lekë/ton, që për 100 mijë tonë që do të jenë në treg, do të jetë 18 milionë e 600 mijë lekë. Nëse nuk do të punohet, natyrisht që punëtorët do të mbesin pa punë dhe janë gati 100 punëtorë mesatarisht. Për këta punëtorë shteti do të paguajë asistencën, sepse me ligj duhet ta marrin asistencën për 1 vit dhe kjo asistencë ka një vlerë 14 milionë e 400 mijë lekë. Nëse i mbledhim të gjitha këto, del se do të mungojnë në buxhetin shtetit 92 milionë lekë, pra do të fitonim nga akciza 100 milionë, por do të mungonin në buxhet 92 milionë lekë. Duke pasur parasysh karburantet që përdoren për të transportuar produktin nga miniera e Selenicës deri te përdoruesi, që është Fabrika e Çimentos, që është një vlerë shumë e madhe, atëherë del se nuk ka asnjë lloj leverdie, përkundrazi, do të ulen të ardhurat në buxhet nga taksa e akcizës.

Problemi i tretë që dua të përmend është problemi social. Duhet të keni parasysh se qyteza e Selenicës nuk ka asnjë lloj aktiviteti tjetër dhe njerëzit janë të punësuar vetëm te ky aktivitet. Në qoftë se ne i heqim nga puna edhe këta 100 punëtorë, atëherë shkaktohet një problem i madh social.

Tjetër problem është se dëmtohen shumë edhe kompanitë të cilat kanë investuar dhe kanë bërë investime të konsiderueshme. Nëse do të ndërpritet prodhimi, këto kompani do të bëjnë shpenzime të tjera plotësuese për t'i mirëmbajtur karrierat, sepse karrierat nuk janë fabrika që mbyllen, por janë miniera, të cilat duan shërbim të përditshëm.

Nëse i referohemi strategjisë minerare që ka shteti shqiptar, një nga objektet kryesore është vënia në shfrytëzim e burimeve minerare të vendit, ndërsa me këtë që do të bëjmë ne, vendosjen e akcizës, nuk do të shfrytëzojmë burimet minerare të vendit dhe këto lekë që duhej të përfshireshin në ekonominë e vendit do të dalin jashtë, sepse përdoruesi do të shkojë të gjejë alternativa të tjera jashtë vendit.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Bombaj!

Zhavorri bituminoz ku përdoret?

Pandeli Bombaj – Zhavorri bituminoz është lënë djegëse dhe përdoret kryesisht në fabrikat e çimentos, por mund të përdoret edhe në fabrikat e tullave ose për prodhimin e gëlqeres,

por kryesisht përdoret vetëm për fabrikat e çimentos, në fabrikën e Fushë-Krujës dhe të Burizanës.

Eduard Shalsi – Nëse do t’u hiqet kjo alternativë fabrikave të çimentos, thatë se do të kërkojnë alternativa të tjera. A ka mundësi brenda vendit apo do t’i drejtohen importit? Pra, koksi është një alternativë tjetër për fabrikat e çimentos, ndërkohë që alternativë tjetër është importi. Pra, zhavorri bituminoz të vijë nga importi?

Pandeli Bombaj – Jo. Nuk ka zhavorre bituminoze nga importi, por do të vijë koks ose qymyre.

Zhavorr bituminoz është emri që i ka vënë populli, por, në fakt, me gjuhën teknike quhet pirobitume, që janë bitume plotësisht të oksiduara që nuk shkrihen dhe përdoren si lëndë djegëse.

Eduard Shalsi – Pra, nëse pengohet kjo, ju thatë se alternativa është koks ose qymyre nga importi. A ka ndodhur përpara që të importohen?

Pandeli Bombaj – Po. Në vitin 2016, me paketën fiskale të vitit 2016, u bë ndryshimi i rentës minerare për zhavorrin bituminoz, nga 6% mbi çmimin që ishte, rreth 160 lekë/ton, u vu 2371 dhe për rrjedhojë u ndërpre për 1 vit të tërë dhe fabrikat e çimentos morën koks nga importi.

Eduard Shalsi – Pra, në vitin 2016 u vendos ligji për rentën minerare dhe demoralizoi kompaninë. Çfarë ndodhi në vitin 2017?

Pandeli Bombaj – U ndryshuar renta minerare dhe u bë 186 lekë/tonë. Nuk u vu me përqindje, por u vu një vlerë fikse që është akoma edhe sot.

Eduard Shalsi – Pra, u vu 186 lekë/ton ndërkohë që ishte 2371.

Pandeli Bombaj – Po. Ndërkohë që më parë ishte 6% e vlerës së çmimit, që shkonte 160 lekë/ton.

Eduard Shalsi – Pra, kemi një ndryshim politike në pak vjet, impakti i së cilës është i dukshëm.

A ka ndonjë pyetje nga kolegët?

Patrick Pascal – Dua të shpjegoj pjesën e investitorëve.

Gloria Çeno – Po prezantohem. Jam Gloria Çeno, Balkan Mineral Invest. Jemi 7 kompani që operojmë në Selenicë për zhavorrin bituminoz.

Unë do të bëj thjesht përkthimin për zotin Paskal.

Eduard Shalsi – Pra, ju jeni 7 kompani që prodhojnë zhavorrin bituminoz në Selenicë dhe s’ka të tilla në vende të tjera të Shqipërisë. Dakord.

Patrick Pascal – (përkthyesja)...

Ai do të shpjegoj se e gjithë puna e zhavorrit bituminoz dhe investimit që është bërë në atë zonë është shpikur nga zoti Paskal.

Në vitin 2011 ka filluar prodhimi i zhavorrit bituminoz ose më mirë të themi nxjerrja nga minierat e zhavorrit bituminoz. Më përpara ky si produkt nuk është përdorur fare në Shqipëri...

(Diskutime pa mikrofon)

Janë vetëm dy blerës në Shqipëri, Fabrika e Çimentos në Fushë-Kruajë dhe Fabrika e Çimentos “Titan”.

Për të bërë këtë biznes kërkohen makineri shumë të rënda. Në vitin 2016 të gjitha këto 7 kompani e ndërprejnë punën në mënyrë drastike. Nuk patën asnjë shitje dhe e gjithë zona, e cila është e punësuar në këto 7 kompani mbeti totalisht e papunë.

Edhe pse pa të ardhur, të gjitha detyrimet që kishim ndaj shtetit janë paguar nga të 7-të kompanitë.

Të gjitha bizneset atje bëjnë një plan biznesi, sidomos bizneset që janë të përgjegjshme si zoti Paskal apo BMI-ja, në këtë rast, dhe kur bëhet një plan biznesi, bëhet afatgjatë, që do të thotë se nuk bëhet për një vit, por bëhet për 5 ose 10 vjet, dhe një ditë të bukur (dua ta shtoj se zoti Paskal nuk e tha këtë pjesën) në fund të vitit 2015 asnjë nga këto biznese që operojnë në zonën e Selenicës nuk u lajmërua, për ndryshimin e rentës minerare, që do të vendosej një çmim fiks dhe në vitin 2016 ne u ballafaquam me një realitet që nuk kishim as ku ta kundërshtonim, as të nxirrnim vlerësimet tona. U vendos një rentë në vlerën 2371 lekë dhe të gjitha këtyre bizneseve, edhe pse kishin një plan biznesi afatgjatë, iu ndërpre puna totalisht.

Dhe ky është një mesazh shumë negativ për të gjithë investitorët e huaj. Në Shqipëri ka vetëm një fabrikë të përpunimit dhe prodhimit të qymyrit koks.

Fabrika e Semanit e ka të pamundur të përdorë këtë produkt në sasi shumë të mëdha, sepse përbërja e squfurit në produktin e Ballshit është 9%, që është shumë e lartë.

Duke qenë se ne jemi i vetmi kompetitor i tyre në treg, duke pasur edhe një përqindje squfuri shumë më të ulët sesa ajo e Ballshit, mendohet se lobizmi vjen nga ato.

Unë kam bërë një petition të firmosur nga të gjithë punëtorët e Selenicës, dhe mesatarisht nga të gjitha këto kompani janë 453 punonjës që e kanë firmosur petitionin dhe nëse akciza do të implementohet, ato do të mbeten të papunë.

Eduard Shalsi – Ju thatë se keni pasur një takim me përfaqësues të ministrisë. Cilat ishin argumentet e tyre?

Pandeli Bombaj – Nuk dhanë argumente.

Gloria Çeno – Ne kemi pasur ndryshime të legjislacionit që nga viti 2015, domethënë se të gjitha kompanitë që operojnë me pirobitumin dhe bitumin natyror, ku në vitin 2015 vendosën një akcizë për bitumin natyror, e kuptuan që nuk funksionoi aspak, se i gjithë produkti për aq pas sa shitet dhe prodhohet, dilte i gjithi jashtë vendit.

Gjatë gjithë vitit 2016 patëm diskutime të vazhdueshme me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Energjetikës dhe në fund të vitit 2016 vendosën që ishte një ngatërresë produkti.

Gjatë gjithë kësaj periudhe këto kompanitë akoma nuk e kanë marrë veten nga ajo humbje e madhe, sepse ka kosto të vazhdueshme, siç e shpjegoi edhe inxhinieri. Përveç këtyre kostove kemi edhe pagesat në shtet, që janë pagesat për tokën dhe qiratë. Ne kemi pasur një takim në AKBN (Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore), ku në asnjë moment nuk është ngritur një grup ad-hoc me ekspertët përkatës për këtë produkt që të pyeten se cilat janë kapacitetet prodhuese, cili është çmimi i tregut, a ka përdorues tjetër përveç këtyre dy kompanive, që janë kompanitë më të mëdha të prodhimit të çimentos. Pra, ky vendim është marrë pa pyetur grupet e interesit dhe ekspertët.

Eduard Shalsi – Sapo na është bashkuar edhe specialisti i Ministrisë së Financave, i cili më pas do të bëjë një koment të shkurtër.

Kalojmë te grupi tjetër, Shoqata e Transportit.

Urdhëroni!

Hazbi Parllaku – Jam kryetar i Shoqatës së Transportit të Qytetit.

Do të flas për disa nga problemet kryesore që ka Shoqata e Transportit të Qytetit, e cila shtrihet në Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë dhe Korçë.

Në vitet e fundit gjërat kanë ardhur duke u vështirësuar, sepse janë rritur shumë kostot me rritjen e çmimit të naftës. Kjo vjen ngaqë 60% të shpenzimeve të transportit e përbën nafta. Çmimi i biletës ka mbetur po ai, shumë i ulët në raport edhe me vendet e rajonit edhe në raport me çmimin e naftës. Çmimi i biletës sot për sot është 30 cent, ndërkohë që çmimi i naftës është

1,4 euro. Po ta shikojmë me Kosovën, Maqedoninë, atje çmimi i naftës është 1,1 euro, ndërkohë që çmimi i biletës është 50-60 cent në Kosovë dhe 60 -70 cent në Maqedoni. Ne kemi bërë disa herë kërkesa për sa i përket transportit për disa shtresa që janë falas. Qeveria ka miratuar disa ligje për t'i kompensuar. Deri tani nuk kanë dalë ende aktet nënligjore dhe efektivisht nuk paguajmë, siç janë kategoritë e invalidëve, të verbërve, veteranëve, të cilët zënë një peshë specifike, vetëm në Tiranë janë 21 mijë udhëtarë në ditë dhe vlera shkon deri në 18 milionë lekë në muaj. Ne i kemi bërë qeverisë disa propozime, disa alternative, që të zbrisë TVSH-në nga 20 në 1-%, sepse shumica e vendeve të KE-së e kanë nga 6, 7, 8 deri në 10%.

Heqja e akcizës së naftës ose heqja e taksës së qarkullimit. Tek taksa e qarkullimit po ta shikosh, meqenëse jemi transport publik harxhojmë se kjo taksë është vendosur për litër naftë dhe duke qenë se jemi konsumatorë të mëdhenj të naftës njëkohësisht rëndohemi.

Po të futemi te problemet, ka shumë, por këto janë kryesoret. Nuk kemi asnjë lloj alternative që të rrisim shpenzimet apo të rrisim të ardhurat. Të ardhurat tona janë qytetarët.

Po ta shikosh para një viti Tirana ka pasur 7 linja, tani janë bërë 14 të tilla. Janë shtuar operatorët, njerëzit janë po të njëjtët, kuptohet janë ulur të ardhurat. Shpenzimet rriten dhe nëse duam që ta mbajmë transportin publik, duhet vënë dorë, të paktën në disa nga këto çështje.

Eduard Shalsi – Pra, TVSH-ja, akciza e naftës, taksa e qarkullimit, këto ishin 3 komponentët.

Hazbi Parllaku - Edhe ne po e shikojmë, se kemi rreth 15 vjet që merremi me transportin publik. Çmimi i biletës bën që të përplasesh me qytetarët, niveli është i ulët. Qeveria duhet të shikojë disa nga këto komponentë. Ne nuk kërkojmë të marrin kompensim, le t'u shkojë kompensimi siç është ligji edhe për të tjerët, shtresave në nevojë.

Eduard Shalsi - Zoti Parllaku, pjesa e biletës ka qenë një debat i madh, shikoj sot këtu edhe zotin Harshova, që ka qenë edhe një kërkesë e shoqatës në lidhje me vendosjen e sistemeve elektronike, pasi ka qenë një burim, përplasje argumentesh dhe abuzimi vazhdimisht.

Luan Leka - Ne jemi dakord që ta vendosim biletën elektronike. Por kemi kërkuar një gjë që kontrollojmë mbi abuzimin e kësaj bilete ta kemi me një status të veçantë. Nuk mund të ma mbrojmë biznesin tim Policia Bashkiake apo Tatimet. Ne nuk kemi asnjë kundërshtim për sa i përket biletës. Le të vendoset bileta elektronike që nesër, por unë duhet ta kontrolloj dhe bileta elektronike duhet të vendoset mbi bazën e një sistemi. Vendoset bileta dhe vendoset sistemi i arkëtimit të gjobave. Kush do t'i vendosë gjobat dhe kush do t'i arkëtojë? Gjërat janë të thjeshta.

Ne sot jemi ndër bizneset më të pastra, edhe pak hile që kemi pas bërë me fatorinot, sot nuk kemi ku të shkojmë se jemi në mes të Tiranës, vjen dikush të bën një foto dhe të vendos 5 - milionëshin.

Eduard Shalsi - Po, qartë.

Ka një pyetje zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani - Faleminderit, zoti kryetar!

Ju përmendët çmimin e naftës dhe të biletës, e krahasuat edhe me rajonin. A keni bërë ndonjë krahasim lidhur me të ardhurat që kanë qytetarët dhe çmimin e biletës? Si është ky raport, krahasuar rajoni dhe ne?

Hazbi Parllaku - Ju mund ta dini më mirë, unë po marr Kosovën...

Eduard Shalsi – Një sekondë, se nuk ka mbaruar zonja.

Eglantina Gjermani – Kjo ishte pyetja e parë.

Pyetja e dytë lidhet me shifrën që përmendët për kategoritë invalide apo për ato të tjera në nevojë, një shifër që m'u duk goxha e lartë. Kemi tregues, kemi numëruar 21 mijë qytetarë në ditë që qarkullojnë në transportin publik, që janë nga kategoritë e njerëzve në nevojë? Më duket një shifër shumë e lartë. Nuk e di nga i keni këto të dhëna. Si mund të ndihmojmë ne për këtë gjë, që të dalin aktet nënligjore që përmendët ju, që të merrni fondet për këto kategori në nevojë?

Hazbi Parllaku - Të dhënat për invalidët ne i kemi nga Shoqata e Invalidëve. Janë librezat që ata i dërgojnë në qytetin e Tiranës. A ka abuzime apo jo? Ne kemi kërkuar që t'i hiqet shoqatës dhe t'i vendosë Bashkia e Tiranës. Ai që merr lekët, ai të përfitojë dhe jo të përfitojnë të tjerët. Këto janë me statistika. Të gjithë ata përdorin transportin. Unë po them se 50% janë false. Mban thesin 50 kile dhe thotë "jam invalid".

Edhe vetë Kryeministri na dha fjalën se do ta bëj këtë gjë, nxori ligjin. Aktet nënligjore kanë 3 vjet që ...

Ligjet janë të pazbatueshme.

Eduard Shalsi – Zonja Gjermani, ajo që mund të bëjmë ne është që të rrisim tryshninë ndaj qeverisë për aktet nënligjore.

Hazbi Parllaku - I kanë caktuar studentët me 30% të çmimit të biletës, ose duhet të kompensohet ose duhet të eliminohet. Një biletë studenti është praktikisht një biletë e

përgjithshme. Sot edhe vlera e abonësë është nën kosto. Po të marrim 25 ditë, t'i shumëzojnë me 2 udhëtime, ndërkohë që janë mbi 3 udhëtime, del 24-25 mijë lekë.

Eduard Shalsi – Kalojmë te Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë. Janë prezentë zoti Leka dhe zoti Hako.

Luan Leka – Problemet që kemi paraqitur ne janë në përgjithësi jo vetëm specifike të prodhuesve shqiptarë, por janë probleme, të cilat u takojnë të gjithë operatorëve të biznesit në ekonomi.

Së pari, duhet të them se draftbuxheti i paraqitur është mjaft i mirë, ka kënaqur shumë kërkesat tona, më i miri që kam parë në shumë vjet biznes. Duhet të themi një fjalë të mirë. Megjithatë ka disa

gjëra të vogla që i kemi thënë më përpara, i kemi thënë edhe në mbledhjen e Këshillit Ekonomik Kombëtar, të cilat mund të rregullohen. U takojnë të gjithëve dhe i ndihmojnë të gjithë.

Po jap disa shembuj. Ne kemi paraqitur edhe një material. Taksat vendore, ligji për taksat vendore, taksa për truallin, në rast se bën një biznes mbi një truall është 35 herë deri 85 herë më e lartë në rrethe të ndryshme të Shqipërisë sesa ajo për qytetarin për përdorim vetjak. Është pak si shumë. Mesatarja është 60 herë më e lartë për të bërë biznes mbi një truall për të krijuar punë, sesa për qytetarin për përdorim vetjak. Mendojmë se është diçka që duhet të shikohet, sepse nuk shkon me frymën e lehtësimeve që duhet të ketë të bërit biznes në Shqipëri, por shkon kundër përmirësimit të klimës së biznesit. Po në këtë ligj, po në këtë kontekst futet edhe ligji “Për taksat vendore”, i cili i jep të drejtën pushtetit vendor të vendosë taksa të jashtëzakonshme për periudha të caktuara në situata të jashtëzakonshme. Kjo është e padefinuar.

Së pari, duhet të definohet se cilat janë situatat e jashtëzakonshme.

Së dyti, duhet të thuhet se sa mund të jetë koha e shtrirjes së kësaj takse.

Së treti, duhet të thuhet se sa e kanë të drejtën ta rrisin këtë taksë. Ne bëjmë propozimet tona. Dakord, ka situata të jashtëzakonshme dhe këto taksa të zgjaten për jo më shumë se 6 muaj, të kalojë jo më shumë se 50% taksën e aprovuar nga parlamenti, përndryshe kalohet në situata që rëndojnë.

Mendoj se këto janë problemet tona, të prodhuesve, por edhe të të tjerëve.

Janë edhe disa probleme të tjera. Kodi Doganor apo ligji “Për procedurat doganore”. Ne kërkojmë një unifikim me ligjin “Për procedurat tatimore” në një pikë shumë të rëndësishme. Bëhet në dogana një kontroll *a posteriori* apo një kontroll nga KLSH-ja, i cili me të drejtë apo pa të drejtë në shumicën e rasteve pa të drejtë korrigjon dokumentet e paraqitura në dogana edhe vite më parë, vendos detyrime që shkojnë edhe qindra miliona lekë për bizneset. Ligji “Për procedurat doganore” apo Kodi Doganor thotë që para se të ankoresh, duhet t’i paguash njëherë këto para. Mund të jetë krejtësisht e padrejtë ajo që është vendosur, siç na ka rezultuar në shumicën e rasteve, megjithatë duhet t’i paguash paratë. Çfarë kërkojmë këtu? Kërkojmë unifikim me ligjin “Për procedurat tatimore”, i cili në një rast të tillë sillet ndryshe. Ai thotë: “T’i paguash ose të vendosësh garanci bankare”. Është viti i tretë që e kërkojmë këtë gjë, gjithmonë kemi një vështirësi përpara, na thuhet se duhet të ndryshohet Kodi Doganor, por duhen dy të tretat, pra i bie që të mos ndryshohet kurrë një gjë e bërë keq. Mendojmë se kjo gjë u rëndon të gjithëve që punojnë me doganat, sistematikisht kohë pas kohe.

Në fushën e tatimeve është një problem që u takon të gjithëve. Zoti Niko i di mirë këto, sepse i kemi diskutuar edhe me Ministrinë e Financave.

Bëhet fjalë për ligjin “Për tatimin mbi ardhurat”. Thuhet se humbjet e aktivitetit mund të mbarten vetëm për 3 vjet. Kjo u rëndon të gjithëve që bëjnë investime, sidomos në veprimtaritë prodhuese, sepse në shumë raste nuk arrihet që në vitin e katërt të realizosh fitime të tilla, që t’i kalojnë humbjet e 3 vjetëve paraardhëse. Nuk e di a e shpjegova qartë. Nëse ke bërë humbje 1 milion euro, duhet që në vitin e katërt detyrimisht të kesh fitim 1 milion euro që ta zerosh këtë, përndryshe po e bërë në vitin e pestë, këto humbje i ke në kurriz, do të paguash tatimin mbi fitimin sikur nuk ke pasur asnjëherë humbje.

Si është kjo gjë në vendet e tjera? Me informacionin që kemi, është kudo më e lartë. Çfarë propozojmë ne? Propozojmë të jetë dhjetë vjet. Për të mbajtur humbjet e krijuara në fillimin e aktivitetit. Kjo besoj se u intereson të gjithëve që investojnë.

Nuk dua të zgjatem. Ka disa probleme të tjera, të cilat do të merrnin kohë, nëse do t’i trajtonim këtu, por i kemi shkruar në relacionin tonë dhe mund t’i shikoni.

Nga ana tjetër, zoti Haka ka disa probleme më specifike, të cilat do t’i trajtojë vetë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit, zoti Leka!

Na ktheve buzëqeshjen me fjalët në fillim. Ka një pyetje zoti Baraj.

Besnik Baraj - Në lidhje me koston e truallit, që thatë se është 60 herë mesatarisht në raport me individin, si është jashtë Shqipërisë?

Luan Leka - Nuk di të përgjigjem. Dua ta studioj rastin që të përgjigjem.

Ilir Beqaj - Në fakt do të lëkundem midis zotit Luan dhe zotit Niko për këtë që tha në fund, që të mos jetë 3 vjet, por më shumë, nuk ka rëndësi se sa, pasi ka pasur raste të tilla. Jemi në gjendje të kthehemi mbrapsht, po bëmë analiza të 5 vjetëve të fundit se si kanë qenë rastet konkrete, sepse që të marrim përsipër se 3 është pak, duhet të jetë më shumë, mund të analizojmë. Ju morët një shembull, por duhet të kishim shumë të tillë për të parë se cila është historia e këtyre 5 apo 10 vjetëve. Sa mund të kthehemi mbrapsht? A i nxjerrim dot të dhënat? Sa kohë ju duhet t'i nxirrni të dhënat? Në bazë të të dhënave mund të analizojmë se çfarë përmasash ka ky fenomen dhe a ka ndonjë sektor ku është më evident apo sektorë të tjerë më pak evidentë. Pastaj mund të arrijmë në një vlerësim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Luan, të mos bëjmë kungulleshkën.

Luan Leka – Nuk bëhet fjalë për falje. Bëhet fjalë që të jepet haku. Të mos paguajë tatim -fitimin më shumë sesa i takon. E quaj shumë të drejtë vlerësimin tuaj, i cili mund të bëhet nga ne, nga një analizë e pjesshme e disa ndërmarrjeve...

Eduard Shalsi – Të dyja bashkë edhe me ministrinë.

Nikolin Lera - Nga Ministria e Financave bëhet në mënyrën më të plotë të mundshme.

Eduard Shalsi - Niko besoj se e mbajte shënim? Se pastaj dua në fund fare të bëni një *rond up*.

Tani Vullneti dhe e mbyllim me dëgjesat?

Vullnet Haka - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të referoja specifikisht për taksën e ambalazhit.

Eduard Shalsi – Po, për të cilën kemi një lajm.

Vullnet Haka - Ia vlen për ta thënë se qeveria me këtë ndryshim që ka propozuar më në fund, pas 8 vjetësh ktheu në normalitet një taksë që ishte bërë barrë në ekstrem për të gjithë aktivitetin ekonomik, sidomos për prodhuesit e ambalazheve, por në reflektimin që ka bërë, për mosnjohje specifike të sektorit janë krijuar disa probleme në potencë. Është propozuar taksë e ambalazheve dhe e produkteve plastike 35 lekë për kilogram në import dhe 25 lekë të gjithë lëndët e para që do të përpunohen brenda vendit. Specifike është se këto janë të gjitha për kodin

“39”, ku klasifikohen lëndët e para të plastikës dhe produktet e gatshme. Po të nisemi vetëm nga kjo, në relacion ne kemi dhënë edhe një ushtrim për çmimin që ka lënda e parë sot. 25 lekë për kilogram i bie që të taksojmë lëndën e parë me rreth 20%. Nëse nisemi nga çmimi mestar një ton produkt plastike, i gatshëm që do të importohet me 35 lekë, e taksojmë diku me 15 %. Që këtu kemi një diferencë me 5% më shumë, që taksojmë lëndët e para që duhet të futen për t'u përpunuar. Duke shtuar këtu që lëndët e para kërkojnë kohën e tyre, minimumi 45-90 ditë të përpunohen, të tregtohen apo të riekportohen, ndërkohë që produktet e gatshme sapo vijnë dhe dalin në treg, e rimbursojnë më shpejt këtë takstë që po flasim.

Ky është problemi më i vogël. Problemi tjetër që lind është se në të gjitha kodet e tjera të nomenklaturës së mallrave nuk taksohet taksa e plastikës. Ka shumë produkte që kanë të inkorporuar në përmbajtjen e tyre nga përqindje të vogla deri në 70-80% plastikë, e cila nuk taksohet për shkak se nuk i përket kodit “39”. Kjo është vendosur vetëm për kodin “39”. Kur vijnë nga importi këto produkte që kanë plastikë brenda nuk marrin taksë. Të gjithë prodhuesit vendas që do të prodhojnë aksesorë plastikë apo pjesë të plastikës për t'i inkorporuar në këto produkte që do të prodhohen këtu, do të shiten këtu, për shkak se lënda e parë hyn te kodi “39”, dhe ka marrë 25 lekë për kilogram taksë. Pra, i bie që automatikisht të çojmë në disfavor prodhimin e brendshëm.

Ka dy mënyra: ose do të filtrojmë për të gjitha kodet plastikën që futet dhe ta taksojmë, që teknikisht është e pamundur, ose do ta zgjidhim me një mënyrë tjetër që taksën për lëndën e parë të mos e bëjmë 25 lekë, por ta bëjmë 10 lekë. Nga llogaritë që kemi bërë, nëse do ta bëjmë 10 lekë do t'i rritet barra për lëndën e parë, taksa do të jetë 8-10%. Unë mendoj se 8-10 % për çdo plan biznesi është e suportueshme, nuk e ndërpresim ciklin. Në të kundërt, kemi këtë fenomen që sapo shpjegova.

Eduard Shalsi - Po, qartë.

Vullnet Haka - Problemi i dytë, nuk është parashikuar një mekanizëm rimbursimi tek taksa e plastikës. Shumë produkte që do të vijnë, do të kalojnë një proces ripërpunimi dhe do të riekportohen apo lëndët e para do të prodhojnë produkte, do të eksportohen. Taksat kombëtare nuk rimbursohen, me përjashtim të rasteve që në ligj është e shprehur e tillë, që të jetë e rimbursueshme. Në momentin që ne nuk do të vendosim rimbursimin në ligj, dhe nuk do të ngremë një mekanizëm rimbursimi, të cilin e kemi propozuar, të gjitha eksportet që kemi në plastikë do të zerohen. Është vetë Ministria e Financave që e ka evidentuar se eksportet e

plastikës së vendit tonë kanë ardhur në një trend pozitiv në rritje. Kjo gjë duhet të reflektohet patjetër.

E fundit për industrinë e riciklimit, për çdo një ton granulat plastike që ato do të prodhojmë, do të shesim brenda vendit apo do të eksportojmë, të ketë një rimbursim prej 15 mijë lekësh të rinj për ton. Kjo shikohet si një mundësi për t'i dhënë përfundimisht një frymëmarrje industrisë së riciklimit që të mos falimentojë përfundimisht. Të rritet sasia e grumbullimi. Nuk është se ky rimbursim do t'u shkojë ricikluesve, është menduar të shkojë te ricikluesit, sepse atje kemi produktin, ku e shikojmë që del. Në të vërtetë ai do t'u shkojë sistemeve të grumbullimit të mbetjeve, por është mënyra më e mirë për ta deleguar atje.

Për të mos marrë shumë kohë, ne e kemi shoqëruar edhe me një relacion të plotë këtë propozim.

Eduard Shalsi – Dakord.

Po, zoti Baraj. Pastaj fjalën e ka zoti Beqaj.

Besnik Baraj – Duam të dimë lidhur me sasinë e granulave plastike që importohen për ditë dhe efektin financiar. Komenti që bëtë ju kur importohen dhe pastaj eksportohen, nuk e di, por përfaqësuesit e Ministrisë së Financave janë këtu, më duket shumë normale, patjetër duhet të ketë rimbursim.

Eduard Shalsi - Ka sjellë një propozim dhe do ta themi tani.

Besnik Baraj – Për të njoftuar edhe Vullnetin, ne këtu në komision kemi propozuar që për të stimuluar grumbullimin e plastikës ta vendosim 10 mijë lekë për ton, ju thoni 15 mijë lekë për ton, sigurisht do ta shikojmë. Efekti financiar i kësaj ishte për 2 mijë-3 mijë tonë. Kemi folur edhe me zotin Luan Leka, që kjo është sasia që gjenerohet në Shqipëri për 2-3 mijë tonë, dhe bëhet fjalë për 210 mijë euro.

Eduard Shalsi – Në rregull.

Besnik Baraj – Pra, nuk ka ndonjë efekt financiar në buxhet.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Besnik, në mos gabo, ne folëm për 10% të asaj, jo për dhjetë mijë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në përqindje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shqetësimi që ju keni në rastin e eksportit u adresua nga ne qëkur na u prezantua paketa fiskale para dy-tre ditësh dhe që atë ditë i kërkuam Ministrisë së Financave të na vinte me një propozim, të cilin e ka sjellë, dhe do ta ndajmë me ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi qenë paralelisht, sepse nuk mund të ishim një hap para jush. Ndërkohë, një nga shqetësimet që ngritët, të paktën për nga mënyra si është shkruar në projekt, më falni që po e lexoj, jemi tek taksat kombëtare, te neni 2 i projektligjit thuhet: “Pika 8 ndryshohet me këtë përmbajtje: “Taksa materiale (kapitulli 39)...”, që nuk ka rëndësi, dhe vijon: “Përveç kapitullit 39, kjo taksë zbatohet edhe kur materiali plastik zë të paktën 51 për qind të sasisë së përgjithshme”. Pra, ne mund të fillojmë ta diskutojmë 51%-shin ose 41%-shin, por nuk është se projekti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ta përjashtoni...

Ilir Beqaj – ... është marrë vetëm 100% për plastikën, por janë marrë edhe ato që kanë përmbajtje plastike.

Më duket se ju thatë 80%, kurse ky thotë që në qoftë se është 51% e sipër, e përfiton përsëri. Si është...?

Nikolin Lera – Jo, taksohet.

Ilir Beqaj – Po pra, por zbatohet e njëjta mënyrë. Të paktën kështu thotë neni.

Nikolin Lera – Kështu ka qenë.

Ilir Beqaj – Nuk e di cilin version keni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, përveç kapitullit 39.

Ju kishit merak, sepse ka edhe gjëra jashtë 39-ës.

(Deputeti Baraj flet pa mikrofon.)

Është këtu, se është mbi 51%-shin.

Nikolin Lera – Nëse është këtu, do të thotë se është taksuar edhe deri tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Po ta lexosh...

Nikolin Lera – Kjo fjali ka qenë në ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Pra, ju kishit merak pse vetëm kapitulli 39 dhe jo të tjerët, por ky thotë: “Përveç 39-ës”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Le të na thotë zoti Lera nëse do të ketë kode të tjera...

Nikolin Lera – Kështu ka qenë ligji dhe është zbatuar.

Burrë – Kjo kështu është bërë për rastet kur taksa e ambalazhit ishte vetëm njëpërdorimëshe. Tani kemi kaluar...

Eglantina Gjermani – Ju lutem, me mikrofon!

Nikolin Lera – ...tek taksimi vetëm kodin “39”. Këtu nuk shprehet.

Ilir Beqaj – Përveç 39-ës pra.

Nikolin Lera – Ky nuk thotë ambalazh.

Nuk shprehet, madje teknikisht kjo është e pamundur, pasi nuk do të arrijmë dot ta bëjmë vlerësimin e kësaj. Vetëm rregullimi i taksës për lëndët e para do ta zgjidhte këtë problem dhe nuk e taksojmë më, nuk kërkojmë të bëjmë kontrolle në të gjitha kodet e nomenklaturës, pasi është e pamundur.

Ilir Beqaj – Tani ka dy momente.

E para, çfarë ka parashikuar normativa e re.

E dyta, sa e zbatueshme është.

Këtu thuhet: “Taksa e materialeve/artikujve plastikë dhe ambalazheve plastike...”, pra nuk bëhet fjalë vetëm për ambalazhe.

Nikolin Lera – Po pra, kjo është risia.

Ilir Beqaj – Vazhdon: ”...të importuara në kapitullin 39, të NKM-së, është 35 lekë/kg. Përveç kapitullit 39, kjo taksë zbatohet edhe kur materiali plastik zë të paktën 51 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit, që ambalazhon produkte të tjera të importuara, të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave”.

Nikolin Lera – Për ambalazhet flet aty, jo për materiale plastike.

Ilir Beqaj – Prandaj them.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shqetësimin në zbatim e sipër, që të mos ketë vend as për interpretime të administratës, që pastaj ju krijon hapësira për diskutime e të tjerë, hajde ta shohim, por...

Xhem Neza– Propozimi ynë, që e njohim sektorin, është të mbetet vetëm te kodi “39”, le të ulet lënda e parë për industrisë prodhuese vendase me 10 lekë dhe e mbyllim këtë, pa hapur procedura pafund, të cilat realisht në terren janë të pamundshme për t’u zbatuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse? Po kur është 49% përmbajtja e plastikës te produkti, a nuk është një avantazh shumë i madh për importuesin? Është, por aty flitet vetëm për ambalazhet.

Ilir Beqaj – Edhe një herë, unë thashë që mund ta diskutojmë përqindjen 51, 41 ose 31, por koncepti është përveç 39-ës, normativa e propozuar e ka hapur, pra nuk ka mbetur vetëm te 39-a.

Xhem Neza– Ne propozojmë që le të rrijë vetëm te 39-a, të ulet me 10 lekë lënda e parë dhe nuk ka nevojë për... Sepse praktikisht është e pamundur, ndërsa po të ishte e mundur, për ne do të ishte shumë mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – E qartë.

(Diskutantët flasin njëkohësisht.)

Një sekondë!

Xhem Neza – Në këtë moment mund të jetë 30 tonë në vit?

Eduard Shalsi – Zoti Naçi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, sepse duhet ta mbyllim në orën 13:30. Domethënë, pozicionet janë të qarta, pastaj...

Fjalën tani e ka Naçi, sepse duhet t’ia jap fjalën edhe përfaqësuesit.

Vullnet, kishe diçka për këtë pikë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta diskutojmë më në detaje pastaj.

Kristo Naçi – Unë e kam shumë të shkurtër.

Bëhet fjalë për një produkt të ri, që është shtuar tek akciza e duhaneve, bëhet fjalë për një paketë që nuk është ngrohje, por me djegie. Ky produkt do të taksohet 3,5 herë më pak sesa paketat e tjera, ndërkohë që në të gjithë rajonin taksohen njësoj, siç taksohet edhe duhani me djegie.

E para, do të ketë një deformim të konkurrencës.

E dyta, do të shkaktohet një dëm shumë i madh në buxhetin e shtetit, pasi ky është një produkt i ri.

Eduard Shalsi – Ju lutem, më konkretisht, për çfarë produkti bëhet fjalë?

Kristo Naçi – Është duhan me ngrohje. Kjo është paketë filtër...

Eduard Shalsi – Nga ato elektriket?

Kristo Naçi – Jo, nuk është elektrike. Është duhan që nuk lejohet të konsumohet në ambiente të mbyllura, si puna e duhanit është, por është... Kjo do të taksohet...? Kjo paketë ka gjashtë gramë, ndërsa paketat e tjera kanë nga 10 gramë deri në 25 gramë.

Eduard Shalsi – Është taksë e re kjo?

Kristo Naçi – Jo, është produkt i ri që futet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Akciza e tij është 35 lekë paketa, ndërsa akciza e paketave normale është 120 lekë paketa. I bie që në qoftë se kjo do të ketë 10 milionë paketa, shteti do të humbasë 7 milionë euro.

Eduard Shalsi – E qartë.

Kristo Naçi – Pra, është një deformim total i tregut, sepse në të gjithë rajonin është njësoj si paketat e tjera.

Eduard Shalsi – Në rregull.

Kristo Naçi – Është e dëmshme njësoj si paketat e tjera. Për mua është shumë...

Eduard Shalsi – Ky është produkt i ri. Mbi çfarë baze taksohet me këtë, si produkt i ri, apo klasifikohet...?

Kristo Naçi – Ligji i akcizave është në vijë.

Eduard Shalsi – Në rregull.

Kristo Naçi – Vetëm për këtë e bën në kile.

Eduard Shalsi – E qartë.

Tani, Niko, të lutem, kemi mbajtur shënim disa çështje, ku një pjesë i ndoqe vetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, ju lutem!

Për zhavorrin bituminoz ka një historik: në vitin 2016, nga 160 lekë, ka shkuar 2371 lekë, pastaj në vitin 2017 qeveria është rikthyer te 186 lekë për ton. Kjo diskonkordancë i ka shkaktuar probleme industrisë, ka qenë një vendim i nxituar, që është pranuar nga qeveria për sa

kohë është korrigjuar, ndërsa sot jemi përpara faktit se zhavorri bituminoz përdoret në masën më të madhe për fabrikat e çimentos, kryesisht dy fabrika të tilla.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëndë djegëse zëvendësuese, me një specifikë që, të paktën nga shënimet që mbajta, nëse për koksin kemi masë të djegshme, që shkon deri në masën 96%, zhavorri bituminoz e ka masën e djegshme 20%.

Më korrigjoni, nëse e them gabim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, 20%-30%. Pra, bëhet fjalë për dy produkte jo të krahasueshme nga pikëpamja e fuqisë kalorifike.

Ndërkohë, u referua që çështja duhet parë pak më gjerë. Aty kemi disa kariera që duan mirëmbajtje të vazhdueshme. Fakti që për shkak të paparashikueshmërisë, planet e tyre të biznesit nuk kishin ndjekur logjikën për të cilën ishin iniciuar, dëmet e periudhës 2015-2016 vazhdojnë t'i paguajnë edhe sot. Ndërkohë, çështja duhet parë si më komplekse, jo thjesht dhe vetëm në lidhje me akcizat 1 lek/2 lekë, por në kontekstin e përgjithshëm të zonës së punësimit, kompanive, e të tjerë. Ndjaj do të doja një shpjegim të logjikës, dhe këtu do ta ndiqnim me shumë vëmendje, në mënyrë që të kuptojmë kontekstin dhe logjikën e ndryshimit. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo ishte e para.

Së dyti, kemi çështjen e kromit.

Unë e di se kemi pasur një debat të brendshëm shumë vite më parë se si të inkurajojmë përpunimin e kromit në Shqipëri, çfarë formash të gjejmë, dhe iniciativa e qeverisë ka qenë e tillë, që të paktën vitet e fundit kapacitetet përpunuese në vend janë rritur ndjeshëm. Çështja është që për sa kohë mungojnë kapacitetet përpunuese, pjesa që prodhohet dhe, me shumë dëshirë, prodhuesit do të donin ta përpunonin në Shqipëri, por tregu nuk mund t'u përgjigjet, atëherë si mund ta ruajnë një balancë?

E dyta, që është rrezik, situata e këtyre dy-tre kompanive mund t'i diktojë çmimet e blerjes së kromit dhe si mund të ndërhyjë shteti, në mënyrë që të mos i lejojë ato dy-tre veta që, duke pasur pozitën e monopolit, duke pasur shumë më tepër prodhim nga ç' mund të përpunojnë, të imponojnë çmime të padrejta.

Dëgjojmë një herë përgjigjen për këto të dyja, për të kaluar pastaj te pikat e tjera.

Në rregull, Niko?

E fillojmë me zhavorrin bituminoz.

Nikolin Lera – Atëherë, në lidhje me zhavorrin bituminoz, ne kemi pasur një konflikt, le të themi, prej tre vjetësh me industrinë. Industria që prodhon lëndë djegëse nga përpunimi i naftës, ato nënproduktet e rënda, koks a si quhet, ka tre vjet që kërkon pranë Ministrisë së Financave me argumente: pse ju nuk taksoni një lëndë djegëse zëvendësuese, por na taksoni ne me akcizë dhe taksë ambientale, taksë karboni?

Vitin e kaluar e bëmë një ndryshim, por ishte gabim teknik, pasi në vend që të taksohej... Domethënë, u identifikua kodi i gabuar. Në vend që të taksohej ajo lëndë djegëse, që përdorej si lëndë djegëse, pra atij zhavorri që përdorej si lëndë djegëse energjetike, kodi u interpretua për një produkt tjetër, që është rëra bituminoze, e cila ka çmim një të tretën e zhavorrit bituminoz dhe përdoret për shtresa të varfra asfaltike të rrugëve rurale.

Tani e korrigjuam dhe vendosëm akcizë mbi produktin që është kërkuar të akcizohet dhe që, bazuar në parimet e akcizimit, shkon si lëndë djegëse dhe zëvendëson një lëndë tjetër. Pse e vendosëm dhe nga cilat kritere u nisëm për nivelin e akcizës? Normalisht, një lëndë zëvendësuese duhet të akcizohet në nivelin e lëndës që zëvendësohet. Lënda që zëvendësohet, po marrim koksin e naftës, që është më kryesori, ka një akcizë prej 2 lekësh/kg dhe një taksë ambientale 3 lekë. Pra, ka një ngarkesë fiskale prej 5 lekësh.

Ne gjykuam...

Eduard Shalsi – 3 lekë është taksë ambientale?

Nikolin Lera – Po.

Ilir Beqaj – 2 plus 3.

Nikolin Lera – Po, dy plus tre, pesë. Ne gjykuam për zhavorrin bituminoz, që të mos ia vëmë këtë ngarkesë fiskale. Morëm edhe çmimet me të cilat është shitur, që variojnë nga 2800 lekë deri në 3000 lekë për ton gjatë një periudhe më tepër sesa njëvjeçare, morëm edhe destinacionet ku shkon, dhe në propozimin e parë thamë që të mos e vendosim taksën ambientale, por vetëm akcizën të barabartë me akcizën që ka lënda të cilën zëvendëson, me qëllim që të kemi në konsideratë edhe fuqinë punëtore, edhe problematikën e zonës e të tjerë. Pastaj reaguam dhe, në bashkëpunim me Ministrinë e Energjetikës, gjykuam përsëri se kjo mund të ishte e lartë. Pse? Sepse akciza përbënte mbi rreth 60% të çmimit të shitjes së këtij produkti për furnaltat.

Konkludua më tej nivelin nga 2 lekë për kilogram, në 1 lekë për kilogram, që përfaqëson rreth 30%-32% të çmimit me të cilin ky produkt shitet pa TVSH.

Kjo është e gjithë situata që ne kemi gjykuar dhe propozuar.

Eduard Shalsi – Në rregull.

Tani, ka disa specifika që e dallojnë dhe krahasimi sipas specialistëve nuk është adekuat. Pra, kemi të bëjmë me një masë, megjithëse konkluzioni është se përdoren për të njëjtin qëllim, dakord, që duhet marrë në konsideratë. Nga ana tjetër, kemi të bëjmë me produkte, me masa të djegshme që variojnë, apo jo? Ky ishte thelbi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolin Lera – Mirëpo parimi i ligjit të akcizës...

Eduard Shalsi – Pra, ka një ndryshim thelbësor. Ndërkohë, produkti përdoret në të njëjtin destinacion.

Nikolin Lera – Po, dhe ky është një parim i akcizës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Pra, pavarësisht se ka fuqi kalorifike të ndryshme, fabrikat e çimentos ose do të përdorin koks të naftës, ose do të përdorin zhavorrin bituminoz, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

Xhem Neza – E përziejnë.

Eduard Shalsi – Po, ose e përziejnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ose për ta ulur...

Xhem Neza – Në fakt, ne po shkelim parimin e akcizës, pasi duhet ta kishim lënë 2 lekë. Megjithatë e ulëm për shkaqet që u diskutuan.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Po, urdhëroni.

Xhem Neza – Atëherë, kur ishte dëgjesa publike, bëmë pyetjen: a ka një analizë ekonomike? Domethënë, nëse vendosim akcizën e zhavorrit bituminoz...

Eduard Shalsi – Çfarë pasojash prodhohen.

Xhem Neza – Po, çfarë pasojash do të ketë, çfarë efektesh ekonomike, çfarë të ardhurash futen në buxhetin e shtetit dhe çfarë mungojnë? Ne dhamë një analizë ekonomike specifike bazuar në të gjithë treguesit ekonomikë që realizohen në vendburime, nga ku rezulton se të ardhurat në buxhetin e shtetit, nga vendosja e akcizës, po të ndërpritet prodhimi i zhavorrit, do të jenë më të vogla.

Eduard Shalsi – Niko...

Nikolin Lera – Mund t'i japim të detajuara.

Eduard Shalsi – Në fakt, na u dhanë disa argumente, si, për shembull, siç u impaktuan në vitin 2016 me masën nga 160 në 2371, u ndërpre dhe u stimulua po i njëjti efekt.

Çështja është që ne duhet të konkludojmë dhe të themi se një masë e tillë, duke shkurtuar aktivitetin, duke riskuar karrierat që duan mirëmbajtje, duke pasur një impakt të punësimit apo njërën, tjetrën, çfarë pasojash na sjell?

Unë e kuptoj parimin, pra dy lëndë që përdoren për të njëjtin qëllim nuk mund t'i trajtosh njërën me akcizë, tjetrën pa akcizë. Por në rastin konkret, cila është specifika?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gloria Çeno – Ministria e Ekonomisë e ka vlerësuar çmimin që shitet koksi në treg me çmimin që shitet pirobitumi? Çmimi ka një diferencë tejet të madhe.

Në qoftë se pirobitumi shitet me 22 euro maksimalisht, koksi shitet mbi 200 e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë, ju lutem, të përfundojë logjika, se e kapëm çmimin tani! Pra, nëse...

Gloria Çeno – Domethënë, nëse diferenca e çmimit ndërmjet pirobitumit dhe koksit është shumë...

Eduard Shalsi – Pirobitumi ishte 22 lekë?

Gloria Çeno – Është 22 euro.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Prisni, ta mbarojë logjikën!

Gloria Çeno – Ajo shitet me të paktën 100 euro për ton, nga çka lind pyetja: a duhet të bëhet vlerësimi i akcizës në lidhje me vlerën e çmimeve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të paktën 100 euro për ton.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë!

Vazhdo, Pandeli, veçse te kjo pikë dhe shkurtimisht.

Pandeli Alikaj – Qymyret që vijnë nga importi nuk kanë akcizë. Pra, është e njëjta lëndë djegëse, si zhavorët bituminozë. Pse bëhet ky përjashtim?

Eduard Shalsi – Në rregull, e qartë.

Fjalën e ka zoti Sinaj dhe pastaj zoti Beqaj.

Vullnet Sinaj – Unë dua të bëj një pyetje të tillë: si çmim bazë i zhavorrit bituminoz dhe çmim bazë i lëndëve të tjera djegëse, çfarë ndryshimi ka për të kuptuar sa ndikon akciza mbi këtë çmim bazë të zhavorrit dhe akciza për produktet e tjera të lëndëve djegëse? Nëse ka diferencë të madhe në çmim, nuk duhet të jetë e njëjta akcizë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë!

Fjalën e ka zoti Beqaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pastaj, Niko!

Ilir Beqaj – Zoti kryetar, unë mendoj se ne duhet të bëjmë një analizë në parim, sepse jemi te ligji i akcizës. Pastaj, nëse për të mos cenuar parimin e të gjithë legjislacionit të akcizës, që është një taksë e rëndësishme në të hyrat tona fiskale, në atë sektor na krijohet një anomali, hajde ta mbështesim sektorin vetëm për këtë anomali që krijohet, jo të prishim parimet e akcizës.

Ju thatë se e përdorin fabrikat e çimentos, të cilat ne do t'i analizojmë se çfarë ndodh me çdolloj lëndë djegëse që ato mund të përdorin, cila është kostoja që u zë atyre lënda djegëse në njësi prodhimi që prodhojnë dhe pastaj të shohim, pavarësisht nga lënda djegëse, sepse ngarkesa fiskale (akcizë dhe/ose karbon) duhet të jetë e njëjtë që të mos përdoret legjislacioni fiskal për të avantazhuar njërin përdorim ose tjetrin. Ato të përdoren për qëllime të tjera, jo për qëllime arbitrazhi fiskal, që mund të burojnë nga hapësirat që krijohen në ligjin e akcizës.

Në qoftë se për atë sektor kjo barrë është më e rëndë dhe mund të sjellë pasoja të tilla, si: nuk mirëmbahet kariera, u prishet punësimi, hajde ta subvencionojmë atë industri specifike, sepse, po e filluam këtë histori, ligji i akcizës shqepet dhe do të vazhdojmë pastaj me duhanin, pasi e gjithë industria e duhanit, nën presionin e nikotinës, po fillon me çdolloj elementi të ri, inovator.

Para disa vitesh cigaren elektronike nuk ta ndalonte njeri. Pse e ndalojnë sot?! Kështu që, hajdeni të bëjmë një analizë të detajuar, madje mund të rrimë deri pasdite lidhur me çfarë ndodh me çdo alternativë lënde djegëse që përdor furra e çimentos apo se sa është ngarkesa fiskale në secilën prej tyre.

Pra, nuk mund të krahasojmë tallashin me qymyrin. Këtu duhet një kile qymyr, ndërsa këtu mund të duhen 100 kile tallash, por norma komplekse, në mënyrë absolute, në qoftë se është e barabartë, këtu kemi qenë *fair* me lëndët djegëse të ndryshme në funksion të asaj që prodhohet. Rëndësi ka çfarë njësie...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, por, në fund të fundit, për çfarë përdoret?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti kërkon njësi kalorifike, nxehje për atë punë. E bën me këtë, me këtë a me këtë, këtu është...

Pandeli Alikaj – Nuk ka rëndësi.

Ilir Beqaj – Në qoftë se ne këtu jemi *fair* me propozimin e ri, pasojat e drejta që mund të krijohen (sociale, ekonomike, kanë bërë planin e investimit dhe të karrierës ambientale), hajde t'i mbështesim me një paketë direkte.

Eduard Shalsi – Qymyri i eksportit nuk ka akcizë, ka fuqi kalorifike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, i importit, ndjesë!

Pandeli Alikaj – E tha zotëria se importi nuk ka akcizë. Atëherë, në këtë rast, çfarë, do të favorizojmë importin se mbledhim taksa nga importi? Ashtu do të lëmë pa favorizuar prodhimin vendas.

(Deputeti Beqaj flet pa mikrofon.)

Ilir Beqaj – Hajde të shohim sa taksa ka, se nuk ka akcizë, por ka taksë karboni, që mund ta ketë dhjetë herë më të lartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj– Nuk duhet të rrimë të lidhur me importin, sepse na sjell të ardhura për buxhetin. Ne duhet të nxisim, duhet të rrisim prodhimin vendas për të bërë eksport.

Eduard Shalsi – Zoti Vullnet, thelbi është ky...

(Diskutime pa mikrofon.)

Patrick Pascal – *(Flet anglisht.)*

Gloria Çeno – Përveç asaj që tha zoti Paskal, që do t’jua përkthej, dua të shtoj edhe diçka tjetër. Sipas kalkulimeve tona lidhur me koksin, mund të them se i gjithë taksimi shkon deri në 16%, ndërkohë që neve na shkon 40%. Pra, e gjithë pjesa e investimit që ne bëjmë, vetëm për karburantin që ne përdorim, shkon 60%. Nga ana tjetër, mënyra si e vlerësuat ju bën shumë sens. Ne e kuptojmë se produktet që përdorim, për të njëjtën industri për djegie, nuk mund që dikush të ketë akcizë dhe dikush jo. Pra, vlera e djegies së produktit tonë, që është pirobitumi, krahasuar me vlerën e djegies së koksit, siç e tha edhe inxhinieri, ka një ndryshim shumë të madh.

Ilir Beqaj - Çfarë do të thotë vlerë djegieje?

Gloria Çeno – Vlerë djegieje do të thotë që për 1 mijë tonë fuqia kalorifike e produktit tonë shkon 30%, ndërkohë koksi e ka vlerën 96%.

Patrick Pascal – *(Flet frëngjisht.)*

Eduard Shalsi – Zoti Patrik, logjika që përdori kolegu im është për t’i dhënë një zgjidhje kësaj situate, por duke mos shënuar parimet.

Ilir Beqaj – Zoti Patrik, kenë shumë të drejtë kur thoni se nuk mund të dëmtohet industria vendase, por ju jeni edhe një investitor i huaj, edhe një qytetar i Bashkimit Europian. Ne e kemi firmosur me dëshirë dhe vetëdije Marrëveshjen e Asoocim – Stabilizimit. Në momentin që ne, për të mbrojtur me të drejtë industrinë tonë, krijojmë një arbitrazh me importuesit europianë, po me bashkëqytetarët tuaj, duke filluar nga ambasada franceze, të cilët do të vijnë këtu dhe do t’u themi: “Ja ku e keni MSA-në, sepse kjo histori ka ndodhur edhe me birrën, edhe me duhanin, të cilat futen po te ligji i akcizës, kështu që ose do të zgjidhni pasaportën atje ose lejen e qëndrimit këtu”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ashtu si e ka taksën karboni, që është shumë herë më i lartë se juaji. Në fund të fundit...

(Diskutime pa mikrofon.)

Nikolin Lera – Zoti Beqaj tha: “Në qoftë se nuk do t’i vendoset taksë akcize zhavorrit bituminoz, atëherë kjo praktikë të përdoret edhe për produktet e tjera”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë dua të sqaroj edhe unë.

Atëherë, shteti shqiptar po kërkon që legjislacioni i tij të jetë si i Bashkimit European ose t'i përafrohet atij. Po të shikosh legjislacionet e vendeve të Bashkimit European, ato nuk kanë akcizë për produktet që tregtohen në gjendjen e tyre natyrale, që nuk janë nënprodukte nafte, për shembull, qymyri. Atëherë, pse kërkohet të vendoset në ligj ky produkt, që nuk është në gjendjen e tij natyrale?

Robert Bitri - Atëherë, mos u fusni te kjo pjesë, sepse zoti Beqaj e tha shumë qartë. Pra, mos u fusni te pjesa e trajtimit me akcizë, por më mirë futuni te pjesa e kostos, në mënyrë që ti të kërkojë një çmim për akcizën 0,001 lekë. Pra, kështu ti del më mirë se sa të futesh te problemi që të mos kesh fare akcizë. Zoti Beqaj ishte shumë i qartë dhe i saktë.

Eduard Shalsi – Zoti Bitri tha se produkte të tilla, për shkak të specifikës, nuk kanë akcizë. Pra, logjika...

Robert Bitri - Logjika e zotit Niko ishte shumë e qartë, por kjo pjesë trajtohet e gjitha me akcizë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Eduard Shalsi – Më falni, ju lutem!

Pra, debati i parë është nëse ky është një produkt që duhet të akcizohet apo jo dhe debati i dytë është në çfarë mase do të jetë akciza. Për të arritur në konkluzionin nëse është një mall që duhet të ketë akcizë apo jo duhet të shikojmë kontekstin. Ajo që tha zoti Niko, që të gjitha produktet zëvendësuese duhet të trajtohen me akcizë bën sens, por, nga ana tjetër, duhet të shikojmë kontekstin.

Pra, ajo që thonë zotërinjtë, që këto janë produkte që nuk kanë akcizë për shkak të specifikës qëndron, apo jo? Në qoftë se kjo qëndron, atëherë logjika që ne kemi përdorur për lëndët djegëse zëvendësuese duhet parë nëse qëndron apo jo në kontekst. Unë sot nuk e kam një përgjigje dhe nuk mund të them nëse ju keni të drejtë dhe nuk mund t'i kundërshtoj zotërinjtë pa marrë përgjigjen e parë dhe më pas të kalojmë te masa. Ka një gjë është e vërtetë që në vitin 2016, për shkak të një anomalie që kemi shkaktuar ne, industria ka vuajtur dhe po paguan pasojat. Tani ne duhet të kalkulojmë mirë dhe të marrim një vendim që pas dy apo tre vjetësh të mos themi përsëri që shkaktuam një anomali. Pra, në qoftë se ne i bëjmë mirë kalkulimet dhe të gjitha analizat e sakta, hajdeni t'i shkojmë deri në fund kësaj gjëje. Nga ana tjetër, do të ndiheshim shumë keq pas gjithë dëgjësave që kemi bërë, sepse ne kemi krijuar disa procedura pozitive në këtë komision, kur pas disa vjetësh të konstatojmë që në vend se të krijojmë atë

parim dhe atë logjikë që do të donim, nuk kemi bërë gjë tjetër vetëm se e kemi rikthyer përsëri situatën e vitit 2006.

Gloria Çeno – A mund të bëj një ndërhyrje?

Këto ndryshime shumë të shpeshta të legjislacionit neve na e kanë bërë të pamundur që të kemi investitorë të huaj. Domethënë, momentalisht ne kemi grupe investimi të huaja, të cilët kërkojnë të futen në zonën e Selenicës për të investuar, por kur shikojnë ndryshimet e shpeshta të legjislacionit në vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2017 tërhiqen totalisht.

Ilir Beqaj – Unë kam bindjen se ajo çfarë tha përfaqësuesi i Ministrisë së Financave në ligjin e akcizës nuk është logjika legjitone, por duhet të jetë e logjika direktivës. Unë dua t'i kërkoja zonjës Xhilda që të më gjejë direktivën europiane të akcizës...

(Ndërhyje pa mikrofon.)

Siç e thashë, nuk dua të mbetem te bindja ime, por dua që të gjej direktivën, sepse ligji për akcizën është i ri, i vitit 2012, nuk është ligj i vjetër. Pra, është e sigurt se në vitin 2012 ne kemi pasur detyrimin e përfarimit të pjesshëm të MSA-së dhe parimi duhet të jetë i sanksionuar në direktivë. Pra, duhet të gjejmë direktivën e BE-së, sepse e kemi në praktikë parlamentare kur e kaluam në vitin 2012 në Komisionin e Integrimit.

Eduard Shalsi – Zoti Niko, shqetësimi im i dytë ka të bëjë me pjesën e kromit, dhe te kjo pjesë kam bindjen time që ato tri apo katër fabrika përpunimi nesër mund të imponojnë çmimet duke na futur këmbët në një këpucë dhe ta bëjnë oligopol. Ndërkohë, pjesa e kapacitetit dhe logjika për të inkurajuar investitorë të tjerë, që prodhuesit ta çojnë mallin tek ata, parimisht qëndron. Pra, ne do të donim që të gjithë zotërinjtë të mos e çonin mallin në Kinë, por ta përpunonin dhe t'i jepnin vlerë në vendin tonë. Kjo mund t'i bëjë shumë njerëz të interesuar për investimin, por ka një periudhë transitore. Sot që flasim ata nuk e kanë mundësinë që ta përpunojnë për shkak të mungesave të kapaciteteve. Logjika *behind* është se si mund ta bëjmë këtë periudhë transitore të zbusë efektin tek ata, në mënyrë që të garantojmë çmimin dhe ta bëjmë procesin sa më *smooth*. Pra, kjo është logjika.

Ka edhe një problem tjetër që, pavarësisht se çmimet e kromit janë të luhatura në bursë, sot që flasim çmimi dihet, kurse referenca ka mbetur në tavan, plus që parashikohet që në çmimin e referencës paguhet edhe për lagështirën, për transportin e të tjerë.

Po, zoti Niko.

Nikolin Lera – Ndryshimi i nivelit të akcizës për mineralin e kromit u kondicionua me faktin që tashmë ka kapacitete përpunuese në vend. Ne duhet të jemi të interesuar që këto kapacitete përpunuese të shtojnë vlerën e pasurive tona minerale, si dhe të rrisim punësimin në vend të eksportit të papërpunuar. Logjika është e drejtë.

Gjithashtu, kishte edhe një analizë tjetër, sipas së cilës nëse në këta dy-tre vjetët e fundit do të vazhdohej me këtë ritëm, që të shfrytëzoheshin rezervat e njohura të kromit në Shqipëri, pas 8 vjetësh këto 3 impiante ku është investuar do të mbyllen, sepse nuk do të ketë më lëndë të parë për ta përpunuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Domethënë, nga dikasteri përkatës neve na u prezantua një material lidhur me burimet në Shqipëri. Kjo ishte panorama pse u rrit renta e kromit. Vërtet që ka një shqetësim lidhur me problematikën e çmimit të grumbullimit nëse kapacitetet e instaluara të këtyre impianteve janë më të vogla se sasia që do të ofrojë në treg përpunuesi. Kjo do të vijë edhe si rezultat i sasive që do të kërkojë tregu i jashtëm me çmimet përkatëse me sasitë që do të kërkojë përpunuesi. A do të ketë ulje të sasisë së prodhimit apo jo, në funksion të zgjatjes së këtyre rezervave dhe fillimit të punës për kërkimin e rezervave të tjera, kjo është një gjë që ne nuk mund ta themi tani. Edhe ministri i Financave me shqetësim e diskutoi dhe këtë gjë në Komisionin e Ekonomisë.

Unë nuk mund të them më shumë se kaq, por po punohet për të gjetur modalitetet e çmimit, në mënyrë që të mos kemi një çmim oligopol të blerjes, njëkohësisht të kemi një konkurrencë dhe një mundësi për eksport përpunues.

Eduard Shalsi – Përveç kësaj, zoti Niko, dua që të mbash shënim edhe pjesën e çmimit të referencës.

Nikolin Lera – Do t'ju shpjegoj edhe këtë, sepse kemi 2-3 vjet që e diskutojmë me ministrinë përkatëse. Çfarë ka ndodhur? Çmimi i referencës nuk ka problem, sepse ne marrim bursën ndërkombëtare, në të cilën thuhet se çmimi i kromit 40-42% është X. Këtë gjë ne e kemi të kategorizuar dhe më pas e zbresim. Pra, nëse një importues e ka kromin 37%, ne zbresim çmimin aq sa e do tjetri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë nuk e di, por e ka sa tregu ndërkombëtar, sepse unë nuk jam specialist i kromit.

Xhem Neza – Unë kam 30 vjet që merrem me këtë punë dhe aktualisht çmimi për eksport i kromit 42% është 210 dollarë.

Nikolin Lera – Këtë duhet t'ia kërkonte organit doganor, që të zbatojë këtë çmim.

Eduard Shalsi - Ju nuk mund të thoni se duhet t'ia kërkojmë organit doganor, sepse ne jemi këtu për të folur me një zë me ta. Pra, ministria nuk mund t'i thotë shko dhe kërkoj doganës....

Nikolin Lera – Por ajo e zbaton, sepse ka një udhëzim të ministrit që ia ka dhënë procedurën.

(Diskutime pa mikrofon.)

Xhem Neza – Nëse sot unë shkoj në doganën e Durrësit për një cilësi të mineralit 42%, CR2O3, çmimi është 210 dollarë, kurse renta llogaritet me një çmim reference 33 mijë e 800 lekë. A shkon kjo me logjikën e veprimit?

Eduard Shalsi - Zoti Beqaj, ju nuk ishit këtu pak më parë, por bëhet fjalë edhe për lagështinë, të cilën këta e paguajnë. Lagështia është një komponent që ndikon në çmim.

(Diskutime pa mikrofon.)

Xhem Neza – Zoti Beqaj, në vitin 2013 ne jemi gjobitur për vitet 2011-2012 dhe 2013 për efektin e lagështisë në minerale. Kush është ekspert këtu, si zotërinjtë Bombaj apo Pandi, që është inxhinier i minierës gjeologjike, e di që çdo mineral e ka përmbajtjen e lagështisë brenda tij. Pra, nuk është normale kur unë eksportoje ose importoj minerale brenda vendit të më zbritet automatikisht vlera e lagështisë, ndërkohë që renta më llogaritet bashkë me lagështinë. Kjo nuk ka logjikë veprimi.

Renta 6% është llogaritur në të gjitha aspektet, duke filluar nga transporti, shërbimet portuale dhe deri në destinacionin përfundimtar të mineralit. Unë jam shqiptar dhe kam shumë dëshirë që ne të kemi fuqi përpunuese të kromit, në mënyrë që mos i ngarkojmë gurët për t'i përpunuar në Kinë.

Unë i kam shëtitur të gjitha fabrikat e ferrokromit në Kinë dhe nuk kam lënë vend pa e parë, sepse kam 22 vjet që merrem me këtë punë, por ndihem i fyer kur shikoj atje dhe shikoj se punëtorët e thyejnë ferrokromin me bishtin e lopatës, sepse nuk kanë kushedi se çfarë ndonjë mekanizim.

A ka kapacitete përpunuese sot Shqipëria? Realisht nuk ka. Siç e thashë, 730 mijë tonë është prodhimi i vitit 2017, ku nga këto 415 mijë kanë shkuar për eksport dhe 153 mijë janë përpunuar këtu.

Unë e falënderoj zotin Shalsi, sepse e kuptoi menjëherë situatën! Pra, si ka mundësi që në 3 subjekte, unë kam 22 vjet që merrem me këtë punë, del dikush tjetër dhe thotë: “Ose do ta sjellësh tek unë me një çmim 100 dollarë ...

Eduard Shalsi – Të lutem, sepse këtë e kemi mbajtur shënim, që do të mos i përsërisim gjërat.

(Diskutime pa mikrofon.)

Zoti Niko, ju do të vazhdoni së bashku me këshilltaren për pjesën e referencës nëse ka apo nuk ka akcizë sipas direktivave.

Së dyti, lidhur me kromin, duhet ta sqarojmë më mirë pjesën e doganës apo të referencës. Unë dua që ju të merrni një përgjigje e saktë dhe t’jua tregojmë me fakte.

Sot unë kam tendencën të besoj se argumentet e atyre që thonë se paguajnë nga xhepi, sepse nuk besoj se janë aq të papërgjegjshëm sa të deklarojnë në një komision parlamentar një diçka ndryshe nga ç’është në realitet. Gjithsesi, këtë do ta shikojmë dhe do ta vendosim se si do ta bëjmë.

Lidhur me çmimin, të cilin ne e kemi mbajtur shënim, është një shqetësim për ne. Gjithashtu, pikëpyetja tjetër për ne, që marrim vendime, është kjo: me këtë inkurajim që po i bëjmë përpunimit vendas mos ndoshta arrijmë të zgjojmë interesat e shumë njerëzve dhe ajo që pritet të ndodhte për 10 vjet në Shqipëri mund të ndodhë për 1 vit?

Sot që flasim ne kemi informacion se ka njerëz të interesuar që duan të investojnë, por duan edhe garancinë që investimi do t’u zgjasë me vite. Këtu po flas për investitorë që duan të investojnë në Shqipëri, sepse ka investitorë shqiptarë, të cilët thonë që nëse raporti i akcizës me eksportin do të vazhdojë kështu, atëherë janë të gatshëm të investojnë, por nëse do të vazhdoni të ruani regjimin e kaluar, atëherë këto investime, që mund të bëheshin për 1 ose 2 vjet, do të bëhen për 10 apo 15 vjet. Ky është një debat që unë e kam në mendjen time dhe nuk e di sesi do ta menaxhojmë.

Xhem Neza – Dua të bëj një sqarim në lidhje me sasinë e rezervave. Miniera e Bulqizës nga 54 milionë tonë rezerva, që ka pasur kur është zbuluar në fillim, vetëm nga një investim që po bëhet në një pus në Bulqizës, rezervat do të shtohen me 3.7 milionë tonë. Nuk është e vërtetë ajo që thanë punonjësit, sepse ato kanë marrë sasinë e rezervave sipas Shërbimit Gjeologjik Shqiptar duke e pjesëtuar me totalin e përpunimit në vit dhe thonë që rezervat mbarojnë për 8

vjet. Kjo nuk është e vërtetë. Unë kam 22 vjet që punoj me nxjerrjen e mineraleve dhe nuk e di se nga merren këto të dhëna.

Eduard Shalsi – Dakord. Kemi përgjigjet që duhet t'i japim Vullnetit për propozimin. A e kemi propozimin gati?

Vullnet Haka – Për plastikën, ne ju dërguam atë çfarë ju kërkuat. Në rast se taksa është paguar në import si në formën e lëndës së parë, ashtu dhe në formën e produktit të gatshëm dhe produkti eksportohet, atëherë do të ketë rimbursim të taksës përkatëse.

Nikolin Leka – Kemi edhe pikën që zoti Beqaj solli në vëmendje, por edhe këtu, po ta lexojmë me vëmendje, flitet për ambalazhe që mbështjell produktet dhe nuk flitet për produktet palastike dhe ambalazhet. Por, nëse do të hynim në një procedurë të tillë, ku sot dogana kontrollon vetëm 10% të zhdoganimeve, atëherë do të hapim një luftë dhe gjueti shtrigash, që do të sjellë dhimbje koke për të gjitha bizneset.

Prandaj mendoj që ta bëjmë 10% lëndën e parë dhe e zgjidhim në sistem këtë gjë dhe e lëmë te 39-ta, të tjerat automatikisht nuk kanë taksë, sepse do të ketë shumë probleme me bizneset.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Përse nisesht me 10%?

Nikolin Leka – Nisem me 10 % , më falni doja të thosha 10 lekë për kilogram, sepse ajo impakton 8 deri në 10% për lëndën e parë si kosto. Me 25 lekë është për 20% mbi lëndën e parë dhe çdo sipërmarrjeje shqiptare po t'i thuash që do të shtoj 20%, e impakton rëndë. Në raport me të gjithë pjesën tjetër që hyn, pra me produktet e tjera, të cilat nuk taksohen, realisht është e pamundur ...

Ilir Beqaj – Pra, me një fjalë dëmtojmë prodhimin vendas dhe ndihmojmë importin.

Nikolin Leka – Po, e dëmtojmë. Kam dhënë një shembull: nëse vijnë një palë këpucë që e kanë tabanin plastik, ato vijnë me kodin 64 dhe nuk do të marrin taksë për tabanin plastik të këpucës. Nëse kemi një prodhues që prodhon tabane plastike për këpucë, kur t'ia shesë fabrikës do t'ia japë me 25 lekë plus, sepse e ka marrë në doganë lënda e parë. Prodhimin vendas të mos e ngarkojmë me një barrë të papërballueshme dhe me 10 lekë për kilogram do ta zgjidhte problemin në përgjithësi.

Luan Leka – Dua të jap një përgjigje shumë të shkurtër.

Eduard Shalsi – Besnik, do ta ndjekësh ti mbledhjen, sepse jam i ftuar në një panel që e kam programuar 2 muaj më përpara. Ju falënderoj, do të mbetemi në kontakt.

Luan Leka – Unë kam një përgjigje shumë të shkurtër për pyetjen që bëri Besniku. Sa është ajo taksë për terrenet e tjera? Ndryshon nga vendi në vend dhe nga rajoni në rajon. Verifikova rajonin e Pulias në Itali, që është i ngjashëm me ne dhe taksat janë të barabarta si për ndërtesat për banim, ashtu edhe për ndërtesat industriale.

Ilir Beqaj – Një sekondë, se nuk kemi mbaruar me kromin.

Luan Leka – Me kromin kemi që në fillim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu thuhet: taksë trualli, në rast se trualli është me qëllim ndërtim banesash ose me qëllim biznesi, ku futet edhe ndërtimi i objekteve industriale. Trualli që merret për të ndërtuar objekte industriale, turistike e me radhë taksohet mesatarisht 60 herë më shumë se trualli që përdor individi për të ndërtuar banesa. Ky është një absurditet shqiptar dhe nuk e di se si ka shpëtuar. Në përgjithësi, kur ndërtohet, paguhet një taksë mbi atë ndërtim që bëhet mbi truall. Tjetër është trualli bujqësor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mora rastin e Pulias, sepse edhe në Itali ndryshon nga rajoni në rajon, dhe taksat i kanë të njëjta si për bërë një banesë, ashtu dhe për të bërë stabiliment industrial. Në Shqipëri ndryshon me 60 herë.

Të them edhe një gjë tjetër, ne kemi tabela gjithandej në Shqipëri dhe taksa e tabelës rezulton 10 deri në 20 herë më e lartë se në Itali. Në Itali ndahet sipas madhësisë së qyteteve, në rast se krahasojmë qytetet, ne taksat i kemi 10 deri në 20 herë më të larta. Pra janë disa taksa lokale, absurde të aprovuara nga parlamenti që vazhdojnë të ngelen kështu pa e ditur njeri, vetëm ne që na vjen radha t'i paguajmë vit për vit.

Unë mendoj se është diçka që mund të shikohet.

Besnik Baraj – Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Do të vazhdoj pak bisedën e kromit.

Besnik Baraj – Ilir, mos ndoshta duhet të kemi një koment nga ministria në lidhje me këtë, sepse duket absurde.

Ilir Beqaj – Edhe unë për këtë absurden e kam. Luan, nuk ta pranoj si absurde.

Meqenëse more si shembull Italianë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të dyja veç e veç. E para, Italia ka barrë fiskale totale, që do të thotë se të ardhurat që mbledhen në raport me GDP-në janë 45%, ndërsa ne i kemi 28%. Pra që nuk kemi ngarkesa në rang vendi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Italia e ka 45% ndërsa ne e kemi 27%. Luan, është shumë e thjeshtë. Ky buxhet na thotë të mbledhim 4 miliardë euro taksa mbi GDP-inë, pra është pjesëtim i thjeshtë. Përse nuk është absurde, sepse kemi vendosur me vullnet politik që të kemi nivele të ndryshme...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E para, janë të ndryshme. Sipas kësaj edhe kalimi nga taksa e sheshtë në taksë progresive ti mund ta quash absurde, unë them jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë po e them, kjo është mënyra se si taksohet në Shqipëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj po të them që nuk është absurde, as për reklama dhe as për këtë. Nëse ti thua që diferenca 1 me 60 është shumë e skajshme apo është absurde, unë ty mund ta pranoj, por që ka dy shkallë të ndryshme të individit nga sipërmarrja, ky është ligji që kemi zgjedhur për taksimin.

Besnik Baraj – Ilir, absurdin për mua e përcakton pesha sasiore, sepse t'i hedhësh kafes një lugë apo një kile sheqer është...

Ilir Beqaj – Këtë model kemi zgjedhur.

Besnik Baraj – Këto mund të jenë të përkohshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Ne mund ta bëjmë taksën e punëtorëve nga 5% në 20 % dhe përsëri jemi shumë mirë.

Te kromi kemi tri probleme. Në të vërtetë ne si deputetë duhet t'i besojmë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, sepse është një shërbim që nuk është në funksion të politikës. Apo jo?

Nëse ata na thonë që ka rezerva edhe për 8 vjet e gjysmë, që do të thotë se kanë ngelur 6 milionë tonë, sepse 700 tonë nxjerrim në vit dhe ju na thoni që vetëm nga investimi i një pusi në Bulqizë balancohet kjo, atëherë do të duhet të ballafaqohemi me ata. Pra, duhet të thërrasim edhe një herë AKBN-në dhe Ministrinë e Energjetikës, që të na thonë se çfarë ndodh me rezervat në 10 vjetët e ardhshme.

Specialist – Kjo është një gjë që vërtetohet shumë shpejt.

Ilir Beqaj – Nëse ne nisemi për të bërë këtë politikë që kemi edhe për 8 vjet rezerva dhe ju thoni që kemi edhe për 18, që këtu fillon loja ndryshe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse nisemi nga dy baza të ndryshme atëherë...

Përparim Alikaj – A mund të jap një përgjigje me aq sa di unë për këtë punë, meqenëse jam edhe profesor në fakultetin e Gjeologji Minerave dhe merrem me këtë punë përditë?

Ilir Beqja – Dakord.

Përparim Alikaj – Unë mund t'ju them që Shqipëria është e pasur me krom dhe me naftë, ndërsa të tjerat janë më pak. Praktika ka treguar që kromi në Shqipëri është akoma i pazbuluar, pra ka shumë krom. Vetë zoti Viktor Doda, përpara dy netësh tha që ne kemi rezerva kromi të pritshme rreth 45 milionë tonë. Unë e thashë më përpara se ju të ishit këtu që ne nuk bëjmë më kërkim për krom. Ne e kemi mbyllur kërkimin e kromit, bakrit dhe të gjitha metaleve me ligjin e ri minerar të vitit 2010. Sot nuk shpohet asnjë metër për asnjë mineral, sepse ligji minerar e ndalon këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jua them unë përse. Ky është fakt dhe unë e kam mbrojtur këtë që nga viti 2010 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

As unë nuk jam me këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo për arsye se ligji ka disa norma të tilla për investimet dhe kompanitë e huaja duhet të paguajnë 300 mijë euro për kilometër katror në vitin e tretë të kërkim zbulimit. Pra, 300 mijë euro për kilometër katror. Kjo është galaktike dhe nuk mund të arrihet dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush e ka bërë, nuk ka rëndësi, por unë di të them se kjo është bërë që në vitin 2010.

Ilir Beqaj – Cila është arsyeja?

Përparim Alikaj – Arsyeja mbase kuptohet, që duan të heqin kompanitë e vogla që futen dhe bëjnë zullume, duke shitur dhe blerë dhe të futen kompanitë e mëdha. Por as kompanitë e mëdha nuk mund të paguajnë 300 mijë euro për kilometër katror në vitin e tretë.

Është e treta herë që e kam ngritur këtë çështje në këtë komision dhe Ministria e Energjetikës bie dakord, ndërsa Ministria e Financave nuk e heq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam shumë dakord me ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj sasia e kromit nuk është 10 milionë tonë. Nëse nuk kërkon, normal që nuk do të gjesh më, por prognoza është 45 milionë tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Cilat janë elementet që duhet të përjashtohen nga llogaritja e rentës, pra nga çmimi i referencës? Ju bëni biznes dhe në parim edhe mbi TVSH-në, edhe mbi shumë gjëra të tjera çmimin e vendosni kur malli vjen në port, sepse aty bëhet eksporti dhe vetvetiu aty ka çmimin me të cilin e nxjerrë transportin dhe disa elemente të tjera...

Përparim Alikaj – Më fal që ndërhyra, por nuk janë këto. Në ligjin minerar thuhet: sa mineral del nga dera e galerisë.

Ilir Beqaj – Unë po marr ligjin fiskal në parim të përgjithshëm të çdo lloj biznesi. Këtu ka njerëz që bëjnë biznes në fusha të ndryshme dhe, kur vjen puna...

Robert Bitri – Në sera mund të prodhojë shumë domate, por ai tatohet për aq sa shet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përparim Alikaj – Më falni, zoti Bitri, ne zbatojmë projektprogramet. Nëse unë nuk realizoj projektprogramin vjetor, atëherë gjobitem nga shteti shqiptar. Është ndryshe me domaten. Unë e kam kriter sasinë e prodhimit nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Robert Bitri – Mos ndoshta për t'i shpëtuar gjobës e rrit prodhimin vetë?

Përparim Alikaj – Jo, këtë s'e bëj dot, sepse kam kosto. Unë prodhoj me financimet e mia dhe jo nga buxheti i shtetit. Por po them që është një metodë krahasimore që nuk shkon.

Ilir Beqaj – Unë po flas për ligjin fiskal. Këto elemente llogarit ligji fiskal, edhe TVSH-në, por edhe elemente të tjera, sepse ky është parimi i përgjithshëm. Unë mund të them se mbas dy vjetësh transporti do të kushtojë 2 herë më pak, sepse Shqipëria investoi 200 milionë euro për atë rrugë. A është kështu apo jo?

Përparim Alikaj – Distanca nuk shkurtohet sado që të shtrohet rruga, sepse distanca në kilometra mbetet e njëjtë. Një kamion nuk ecën dot si një veturë, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Ai kamioni tani torturohet nga Burreli për të dalë në Rrëshen, ndërsa kur të shtrohet rruga ai do të vijë si varkë.

Përparim Alikaj – Ju shyqyr që jeni i deleguar i Tropojës, Tropoja dhe Burreli kanë një distancë prej 100 kilometrash.

Ilir Beqaj – Unë jam deputet i Bulqizës dhe i Matit.

Elementet e kësaj gjëje janë të përgjithshme. Halli që ju keni në këto tri vjet është lagështira. Unë kam përshtypjen që për mineralin e kromit ju keni ngritur pretendimin që lagështira është 30 %.

Xhem Neza – Jo, 30% nuk e ka thënë kush.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë nuk e kemi thënë. Në raste të veçanta mund të shkojë deri në 5.8%, ndërsa koncentratet pluhur që kanë përmbajtjen më të madhe të lagështirës, sepse lagen, mund të shkojnë deri në 10 %. Nuk e ka thënë njeri që shkon deri në 30%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Unë po them se çfarë pretendohet dhe këtu është problemi. Por edhe këtu kemi dy pozicione të ndryshme nga dy drejtori të ndryshme të shtetit shqiptar, nga Drejtoria Minerare dhe nga ...

Nikolin Lera – Ne kemi bërë edhe një draft para dy vjetësh me 5% lagështirë dhe nuk është pranuar nga Drejtoria e Përgjithshme Minerare.

Xhem Neza – Zoti Niko, a e kuptoni efektin në doganë? Nëse sot unë shes në doganë, të ardhurat me vijnë për krom të thatë dhe jo të lagur, ndërsa rentën e paguaj për krom të lagur dhe jo të thatë. Ky është një krahasim më primitiv. Pra unë marr lek për krom të thatë, ndërsa rentën e paguaj së bashku me përmbajtjen e lagështirës.

Nikolin Lera – E kuptoj. Ne kemi dy vjet që jemi në diskutime, madje edhe draftet i kemi gati dhe më duket se është futur edhe në Këshillin e Ministrave, që të njihet elementi i lagështirës dhe ne konkludim një nivel lagështirë të njohur prej 5%. Pra, nëse t'i çon 20 ton krom për eksport, të skontohej 5% dhe renta të llogaritet mbi diferencën. Ne jemi në mosdakordësi me Drejtorinë e Përgjithshme Minerare, sepse ata gjykojnë që niveli duhet të jetë më i lartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Sa zgjat procedura e bërjes së analizave?

Besnik Baraj – Analiza është shumë e thjeshtë.

Xhem Neza– Kriteri që ne propozuam ishte niveli i lagështirës i pranuar me analiza, por jo më shumë se 5%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolin Lera – Më falni, por ne nuk jemi mbledhur për të bërë këto punë që i bën komisioni *ad hoc*. Kur të mblidhet komisioni *ad hoc*, i cili cakton anët teknike të lagështirës dhe të parametrave të tjerë, atëherë mund të caktohen edhe sipas eksperiencave të ndryshme për çdo minierë. Ne nuk mund të marrim përsipër punën e Drejtorisë së Licencave në ministri, pavarësisht nga eksperiencat tona nga miniera të ndryshme. Lagështira është funksion edhe i thellësisë së vendosjes së mineralit, pra ka ndryshime të mëdha. Por nuk po hyjmë te kjo, sepse nuk është lagështira ajo që ngre peshën kryesore këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është diçka anësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Ilir, ne kemi ardhur për këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë sot prodhohen 730 mijë tonë në vit, nga të cilat përpunohen dhe mbeten pa u përpunuar 300 mijë tonë.

Robert Bitri – Çfarë doni nga ne?

Xhem Neza – Renta minerare është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E para, është mos ngritja e rentës minerare në 9%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Më falni, por dua të jap edhe unë një interpretim, meqenëse merrem me analizën kimike, pra jam kimist analist. Ajo që propozon ministria mendoj që është një vlerë e mirë për ju, sepse intervali në të cilën ndryshon lagështira nga stina në stinë në varësi nga përmasat e grimcave, mund të jetë nga 3 deri në 6 apo 7%, prandaj gjetja e një vlere mesatare afrohet shumë pranë vlerës reale vjetore të përmbajtjes së lagështirës së mineralit total që ju eksportoni. Unë nuk mendoj që ia vlen të diskutohet që duhet 5.1, 4.7 apo duhet 5.5. Pra, nëse është arritur të përcaktohet që ndaj çdo minerali të hiqet 5% e vlerës për shkak të lagështirës, unë e quaj të favorshme për ju. Pra, të mos e bëjmë objekt. Nëse ndonjëri ka dëshirë të flasë...

Përparim Alikaj – Kjo është e keqja, sepse zoti Ilir, nuk ishte këtu kur dhamë shpjegimet në fillim. Ne jemi kundër rritjes së rentës minerare nga 6 në 9%.

Besnik Baraj – Pra ky është thelbi juaj.

Përparim Alikaj – Jo, nuk është vetëm lagështira. Nëse ne nuk përpunojmë 300 mijë tonë mineral në vit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Më tej mund të vazhdoni me Nikon, për ndonjë gjë të veçantë që keni.

Në lidhje me cigaren.

Nikolin Lera – Në lidhje me cigaren. Në këto vitet e fundit nuk përdoret më cigarja tradicionale, që ne e akcizojmë, por kanë filluar të përdoren edhe forma të tjera, një ndër to është edhe cigarja me ngrohje. Çfarë është kjo? Është një pajisje, një aparat, ku futet një kapsollë, që është duhan, por që ka karakteristika, në kuptimin e dëmit të shëndetit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka karakteristika shumë më të përmirësuara, krahasuar me cigaren tradicionale.

Ne e kemi të patakshur, por tani po zëvendëson edhe cigaren tradicionale, nisur edhe nga politika për dëmin që shkakton dhe gjëra të tjera të kësaj natyre.

Vendosëm ta akcizojmë dhe pamë si akcizohet në vendet e tjera. Kudo akcizohet me kilogramë, sepse variantin e parë e llogaritëm me të njëjtën akcizë, siç e llogarisnim për një cigare, por arritëm në konkluzionin se nuk mund të paguajë të njëjtin nivel akcize një cigare që është 10 centimetra dhe një cigare që është 1,5 centimetra.

Pamë edhe nivelin e akcizës, se sa shkon për një fije akciza e cigares dhe sa shkon për një fije akciza e këtij produkti të ri. Nisur nga fakti se pesha e duhanit të një cigare kaliske është trefish krahasuar me këtë cigare, si dhe dëmet që shkaktohen janë më të larta në cigaren klasike, nisur edhe nga përvojat e vendeve të tjera, që e kanë të diferencuar akcizën dhe akcizën e këtij produkti të ri e kanë në nivelin më pak se 50% të nivelit të akcizës së cigareve, llogaritëm që niveli i akcizës, që do t'i vendoset këtij produkti të ri, të jetë jo gjysma e ekzistuesit, por diku të 70% e lartë.

Kristo Naçi – Pse, akciza e të tjerave është 120 lekë për paketë...?

Nikolin Lera - Llogaritjet janë bërë që për çdo gramë duhani, akciza e këtij produkti të ri, që dëmton më pak shëndetin dhe nuk shkakton shumë probleme, të jetë 65-70% të nivelit të akcizës për një gram duhan në cigare.

Kristo Naçi – Nuk është 70%, por është 35 lekë për paketë.

Besnik Baraj – Si përqindje i bie 20%.

Nikolin Lera – Ne e kemi për kilogram.

Kristo Naçi – Sipas direktivës së Europës thuhet se...

Nikolin Lera – Zoti Naçi, unë mund t'ju jap edhe llogaritjet që kemi bërë, si dhe përvojën ku jemi bazuar për të ofruar këtë nivel akcize.

Kristo Naci – Sipas direktivës së Europës, çmimi i akcizës për produktet e duhanit duhet të jetë 50%. Nuk mundet të shitet 3 mijë lekë dhe të paguhet akcizë 35 lekë. Ky është deformim total i tregut.

Nikolin Lera – Naçi, sipas direktivës së Europës, edhe për cigaret klasike ne duhet të kemi një akcizë 92 dollarë për 1000 fije, por e kemi 60.

Tani, a jeni dakord që akcizën e cigares nga 120 lekë për paketë që është aktualisht, ta rrisim në 300 lekë për paketë?

Kristo Naçi – Jo, ta bëjmë sipas fuqisë blerëse.

Nikolin Lera – Nëse ju jeni dakord me këtë, hajde ta rrisim në standardin e direktivës edhe cigaren tjetër!

Besnik Baraj – Meqenëse ka dy burime të ndryshme dhe ne nuk i konfirmojmë dot se kush ka të drejtë, prapë ju do ta zgjidhni këtë bashkë me...

Ilir Beqaj – Do t'i bëj Naçit një pyetje.

Do t'ju lutesha të më shpjegonit më mirë se çfarë sjellë në treg kjo?

Pse mendon se duhet rritur akciza? Na e shpjego.

Kristo Naci – Për mua, nuk është se sjell diçka ndryshe në treg, për ne është njësoj e dëmshme.

Ilir Beqaj – Po flas si tregtim, jo si cilësi.

Kristo Naci – Si tregtim... Është diçka e re dhe nuk dihet se sa treg do të marrë. Mund të kapë edhe 20% të tregut. 20% e tregut i bie të jenë rreth 30 milionë paketa dhe i bie që shteti do të humbasë 20 milionë euro nga kjo taksë e re.

Ilir Beqaj – Naçi, ti mendon për shtetin apo për biznesin?

Kristo Naçi – Patjetër që për biznesin.

Marlboro këtë gjë e ka bërë patentë për 5 vjet në gjithë botën, që i bie... Tani po vjen edhe në Shqipëri, kurse në vendet e rajonit taksohet njësoj.

Në Greqi 4 euro është paketa e zakonshme. 4 euro është edhe kjo, që është...

Besnik Baraj – Unë mendoj që edhe këtë problem ta zgjidhni bashkë me Nikon.

Keisto Naçi – Po të jetë 70%, dakord, por...

Besnik Baraj – Nuk e di, a ka ndonjë merak tjetër?

Ilir Beqaj – Besnik, kam dy pyetje.

Kiço, për paketën klasike sa akcizë paguhet në lekë sot?

Kristo Naçi – 120 lekë për paketë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ligji është me fije.

Ilir Beqaj –Kjo paketa që do të vijë, sa do ta ketë akcizën?

Kristo Naçi – Nga 1 janari do të paguajë 35 lekë për paketë, për 20 fije.

Ilir Beqaj – Një duhanxhi i zakonshëm, që ka pirë një paketë në ditë nga jjo e vjetra, sa paketa të tilla do të pijë?

Kristo Naci – Do të pijë më pak.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Besnik, duhani është ves, ti nuk e merr se ke nevojë për atë ilaç. Duhani është ndryshe... Nuk është se ti ke nevojë të marrësh shiringën në mëngjes dhe do të marrësh kaq e do ta lësh gjysmën e shishes për nesër. Është çështje tjetër perceptimi i duhanit.

Kristo Naçi – Për sa u përket cigareve të zakonshme, ato fillojnë nga 10 gramë-25 gramë Me ligjin e ri u vendosur që akciza të jetë për fije. Cigarja Slims është 10 gramë për paketë në ditë, por paguhet për 20 gramë.

Ilir Beqaj – Nuk kam mbaruar.

Me sa lekë del Marlboro klasike në treg me pakicë?

Kristo Naçi – Këtu në Shqipëri është 300-350 lekë.

Ilir Beqaj – Po kjo sa do të dalë?

Kristo Naçi – Këtë nuk mund ta di akoma.

Bsnik Baraj – Konsumojeni bashkë këtë.

I fundit është zoti Hazbi.

Kjo është ndërhyrja e fundit para se ta mbyllim.

Po, zoti Hazbi.

Hazbi Parllaku – Patëm tri propozime, që ia kemi çuar dhe ministrit të Financave. Nuk e di, çfarë komentesh ka Ministria e Financave për transportin publik qytetas?

Nikolin Lera – I kemi marrë peticionet tuaja dhe i kemi parë me kujdes. Në pikëpamjen e politikave fiskale u gjykua që incentivimi, që do të jepej me këtë paketë, ishte ulja e TVSH-së për importimin e autobusëve me motorë elektrikë nga 20% në 10%.

Problematika tjetër, që ka të bëjë me heqjen e akcizës për karburantin që konsumoni, heqjen e taksës së qarkullimit apo me rritjen e çmimit të biletës, nuk u pa si pjesë e kësaj pakete.

U adresua edhe problemi i nxjerrjes së akteve nënligjore...

Ilir Beqaj –Më fal!

Pse, çmimi i biletës rregullohet me paketë?!

Luan Leka – E përmenda në kuadrin e atyre dy të parave (të më falni).

U diskutua edhe me drejtorinë e buxhetit dhe strukturat që kanë për detyrë të nxjerrin aktet nënligjore, që në zbatim të ligjit të përshpejtojnë punën për nxjerrjen e tyre.

Pra, që ta përmbledh, për heqjen e akcizës (për të cilën përgjigjem unë) apo heqjen e taksës së qarkullimit për karburantin, që harxhojnë shoqëritë e transportit publik, u pa më e arsyeshme të jepet një incentivë tjetër, që ka të bëjë me importimin, për nxitjen e autobusëve me motorë elektrikë.

Hazbi Parllaku – Ç’lidhje ka kjo? Sot nuk ka autobusë elektrikë, ne po flasim për sot. Ç’lidhje ka autobusi elektrik me autobusin që kemi sot?! Ne po flasim për problemet që kemi aktualisht. Autobusi elektrik është si puna e asaj që Tirana ka nevojë për një 5 linja metroje dhe hajde t’i bëjmë!

Nikolin Lera – Një masë e tillë u ndërmor, që, duke filluar nga viti 2019, të nxitet importimi i tyre, ndërkohë që nuk u pa e arsyeshme heqja e akcizës apo e taksës së qarkullimit për këtë kategori që ju propozuat.

Hazbi Parllaku – Ne po transportojmë njerëz pa para. Kjo nuk ndodh në asnjë vend. Çmimet janë si në Afrikë, nafta është si në Europë. Kjo është jashtë çdo logjike!

Besnik Baraj – Duke falënderuar të gjithë kolegët për durimin, e mbyllim këtë mbledhje!

Do të jemi në kontakt për shqetësimet që ngritët.

Për mua, e veçanta ishte që krahas shqetësimeve që ka çdo vit, pati dy elemente të reja: vlerësimet për buxhetin dhe njëkohësisht përfaqësuesi Naçi, që ishte i shqetësuar për faktin se buxheti do të humbasë 39 milionë euro.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA